

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

26.10.2020

Ora 11:05

RENDI I DITËS

Projektakti "Shqyrtimi dhe miratimi i projektrregullores për organizimin e mbledhjeve të Komisionit Rregullator".

PJESËMARRJA :

- KQZ:
- Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y.Merkaj, E.Jorgaqi
- Parti Politike PR, LSI
- Vëzhgues: KRIK

Znj.I.Nano: Faleminderit për praninë, fillojmë sot mbledhjen e parë publike të Komisionit Rregullator. Janë të pranishëm pesë anëtarët e Komisionit Rregullator. Gjithashtu në mbledhje është i pranishëm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të administratës së KQZ-së, përfaqësues të partive politike të ftuar. Sot mblidhemi për të shqyrtuar dhe për të miratuar Rregulloren e mbledhjeve

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

dhe funksionimit të Komisionit Rregullator. Kemi vetëm një pikë në rendin e ditës. Mbledhja është thirrur me njoftim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Është prezantuar drafti dhe relacioni përkatës. Do të ftonim Komisionerin, apo një përfaqësues të administratës së KQZ-së për të prezantuar projektaktin dhe më tej të vijojmë me shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Z.I.Celibashi: Faleminderit zonja Kryetare, ju uroj Ju dhe anëtarët e tjerë të Komisionit Rregullator, suksese në punën tuaj. Pa dyshim si një mbledhje e parë e kësaj strukture ka gjëra që në aspektin procedural nuk kanë atë qartësinë që do të duhet të kishin. Por, besoj me miratimin e këtij akti nga Rregullatori, shumë aspekte të marrëdhënieve ndërmjet më së pari të zhvillimit të aktivitetit dhe funksionit të vetë Rregullatorit por dhe të raportit të kësaj strukture me Komisionerin dhe me KAS-in besoj se do të jenë shumë mirë të përcaktuara. Drafti që ne kemi përgatitur ka synuar që në mënyrë shteruese të trajtojë të gjitha ato çështje që lidhen me kompetencën e Rregullatorit. Më së pari për mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e kësaj strukture, po kështu dhe për ato aspekte që lidhen me raportin e kësaj strukture dhe të strukturave të tjera drejtuese të KQZ-së sikurse është dhe Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet dhe KAS-i. Materiali.. besoj se jeni njohur me përmbajtjen e këtij drafti. Unë nuk do dua të zgjatem shumë, sepse është tërësisht atributi juaj për të vendosur dhe për të disponuar në lidhje me këtë rregullore. Sikurse e thashë dhe pak më herët, jemi përpjekur të paktën në vlerësimin dhe gjykimin tonë t'i trajtojmë në mënyrë shteruese të gjitha ato çështje që lidhen me funksionimin e Rregullatorit, me funksionimin e mbledhjeve, me zhvillimin e tyre. Me mënyrën se si shqyrtohen çështjet dhe organizohen ato në një rend dite të caktuar. Cila është pozita e palëve të interesuara në këtë diskutim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Formën e nxjerrjes së aktit, mënyrën e bërjes publike të tij. Më parë dhe për formën dhe organizimin e mbledhjeve të Rregullatorit, pjesëmarrësit në këtë mbledhje dhe të tjera elemente si këto. Drafti është organizuar në gjashtë kapituj dhe janë tridhjetë e gjashtë nene të cilat rregullojnë ato të cilat unë parashtrova. Pa diskutim që ne jemi të hapur për çdo rekomandim, apo sugjerim i cili do të duhej të ishte përfshirë në këtë, por tashmë si të thuash topi është në fushën tuaj dhe ju keni gjithë të drejtën për të vendosur dhe për të përshtatur këtë draft si ju ta çmoni. Çdo strukturë, apo institucion tjetër është i detyruar që t'i bindet atij rregullimi të cilin ju do ta miratoni. Më shumë nuk po zgjatem se sikurse thashë, jeni ju ajo trupë që do të diskutoni të gjitha propozimet që ne kemi paraqitur dhe që do të vendosni në fund fare. Faleminderit dhe ju uroj suksese!

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Celibashi, pas prezantimit të projektregullores të krerëve kryesorë të saj dhe të rregullimeve përkatëse nga ana e Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet si organi që ka njoftuar thirrjen e mbledhjes dhe ka propozuar këtë akt. Unë do të doja të thoja dy fjalë për rëndësinë e rregullores së mbledhjeve të Rregullatorit. Në fakt çdo organ ka nevojë për rregulla më të detajuara përveç atyre që parashikohen domosdoshmërisht në ligj dhe konkretisht në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, për të organizuar veprimtarinë e vet, aq më tepër që Rregullatori si një ndër organet drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e zhvillon veprimtarinë e tij në mbledhje publike, të cilat do të duhet të jenë, sa më të rregulluara dhe disiplinuar me rregulla të detajuara. Ndërkohë është dhe një detyrim në Kodin Zgjedhor, pra në nenin 20, pika 1, germa "d", ligjvënësi ka vlerësuar që vetë Rregullatori të miratojë rregulloren e vet, por dhe rregulloren e organeve të tjera siç është KAS-i që mendojmë se në ditët në vijim do të jetë gati për t'u shqyrtuar dhe miratuar dhe kjo rregullore. Duke

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

qenë se ende nuk e kemi miratuar rregulloren, pra ende ne nuk kemi rregulla të shkruara e të miratuara për zhvillimin e mbledhjes. Nga mbledhja e ardhshme ne sigurisht që do t'i referohemi të gjitha neneve të rregullores për çdo procedurë që zhvillojmë në mbledhje, unë në këtë moment do të ftoja kolegët anëtarë të Rregullatorit për të diskutuar në parim e më tej për ta votuar në parim, pa hyrë në detaje nen për nen. Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve, më lejoni të përshëndes siparin e çelur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, por për qartësi të grupeve të interesit dhe interesit publik mbi të gjitha, do të doja të qartësoja, ose të ndaleshim pak në iniciativën e marrë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i përfaqësuar nga Komisioneri në këtë rast, e cila s'do të doja të lexohej si një ndërhyrje, por thjesht Komisioneri shoh që është përpjekur t'i japë solemnitetin e duhur dhe do të doja të lexohej e të ndalej vetëm këtu. Pasi organi i Komisionit Rregullator, apo siç ne e kemi parashikuar në rregullore Rregullatori, është një organ i pavarur dhe një nga tre organet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Duke qenë se palët politike u përpoqën që të sheshojnë, le të themi këtë "kolaps" të çështjeve zgjedhore duke gjetur një sistem, apo një gjë të përbashkët për organe të reja të cilat domosdoshmërisht për një veprimtari të ligjshme bazohen në pavarësinë e tyre. Mendova të ndalesha dhe të theksoj që kjo rregullore vërtet është një draft i sjellë nga administrata e KQZ-së, por bashkë me kolegët, ne kemi dy javë në veprimtari shqyrtuese. E kemi shqyrtuar individualisht dhe më pas në grup për të sjellë një akt që nuk do të cënojë asnjë nga tagrat, atributet, por do të sjellë një veprimtari objektive, të qëndrueshme dhe mbi të gjitha ligjore. Kaq kisha, i uroj kolegëve punë të mbarë dhe faleminderit Kryetare!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Faleminderit zonja Vukaj, po zoti Çela!

Z.A.Çela: Përshëndetje, kisha një propozim për sa i përket draftit që na ka paraqitur Komisioneri, besoj dhe kolegët janë të një mendimi me mua. Gjëja e parë që përveç stemës “Republika e Shqipërisë”, “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, Komisioni Rregullator”, të vret sytë “Komisioni Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”. Ne jemi organ vendimmarrës, organ kolegjal dhe mendoj se duhet të jetë Komisioni Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, jo “pranë”. Nuk e di kolegët ç’mendim kanë.

Znj.I.Nano: Faleminderit, këto propozime dhe rregullime do t’i bëjmë sapo ta miratojmë në parim dhe pastaj e kalojmë nen për nen. Në qoftë se nuk ka gjë tjetër në parim a mundet të kalojmë në votimin në parim të rregullores.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka


Miratohet në parim!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen dhe meqenëse zoti Çela e nisi nga titulli, pra propozimi juaj është “Rregullore e mbledhjeve të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”?

Z.A.Çela: Po!

Z.M.Çakaj: Mund ta bëjmë dhe më shkurt “Rregullore e mbledhjeve të Komisionit Rregullator”. Për sa kohë poshtë stemës së aktit është përcaktuar “Republika e Shqipërisë”, “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, më poshtë vjen “Komisioni

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Rregullator”. Për të unifikuar dhe terminologjinë, pas rregullores së mbledhjeve mund ta bëjmë shkurt “Rregullore e mbledhjeve të Komisionit Rregullator”, në se kolegët e miratojnë si propozim. Sigurisht ligjvënësi në Kodin Zgjedhor ka parashikuar në mënyrë të qartë vetëm organet e reja drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kjo rregullore, rregullon veprimtarinë e organit ligjvënës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe në këtë funksion duke qenë se dhe akti i mëpasshëm do të jetë Rregullore e KAS-it, kështu që për t’u unifikuar si praktikë, unë propozoj ta bëjmë “Rregullore e mbledhjeve të Komisionit Rregullator”. Në se jeni dakord.

Znj.I.Nano: Meqenëse zoti Çela pajtohet me propozimin e zotit Çakaj, atëherë votojmë titullin “Rregullore e mbledhjeve të Komisionit Rregullator”.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Do t’i luteshim administratës që ta pasqyrojë në draftin përfundimtar, edhe ku përmendet më tej, në nenin 1 të kësaj rregulloreje është e njëjta shprehje “pranë KQZ”, të pasqyrohet në të njëjtën mënyrë.

Në nenin 1, sikundër jemi njohur pika 1 ka qëllimin e rregullores, pika 2 objektin e rregullores, do të propozoja që në vijim të jetë pika 3. Kjo rregullore përcakton rregullime në lidhje me:..

Z.M.Çakaj: Atëherë, unë kam një propozim tek pika 2 që vijon “Kjo rregullore përcakton rregullime në lidhje me:” unë kam një riformulim të pikës “a”. Kjo rregullore përcakton rregullime në lidhje me “kompetencat, të drejtat dhe detyrat e Rregullatorit”. Pra ishte, “mënyrën e ushtrimit të kompetencave të Rregullatorit,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

të drejtat dhe detyrat e Kryetarit dhe anëtarëve të Rregullatorit” të bëhet “kompetencat, të drejtat dhe detyrat e Rregullatorit”. Pra bëhet më e thjeshtë dhe më funksionale për të gjithë.

Znj.I.Nano: Në fakt një debat të vogël, kompetencat e Rregullatorit janë parashikuar në ligj kështu që në këtë rregullore detajimi i rregullores këtë nënkupton, mënyrën se si ushtron kompetencat. pra, në thelb dhe në përmbajtje nuk ndryshon asgjë. Janë të parashikuara nene të veçanta për kompetencat më tej që janë në fakt të marra nga ligji. “Mënyra e ushtrimit të kompetencave”, unë mendoj se është shprehja e duhur.

Z.M.Çakaj: Dakord, atëherë “mënyra e ushtrimit të kompetencave, të drejtat dhe detyrat e Rregullatorit”.

Znj.I.Nano: Po, nuk e di në se, pra riformulim “mënyra e ushtrimit të kompetencave, të drejtat dhe detyrat e Rregullatorit” dhe më tej kemi nenet të detajuara si për anëtarët, si për kryetarin. Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Kemi pikën “f”, mendoj se duhet hedhur për diskutim, sepse në vështrim të parë dhe në përputhje me çfarë prezanton kjo rregullore, druaj se nuk është atribut i kësaj infrastrukture fillestare, pra i nenit 1 dhe s’duhet të jetë pika f që thotë “procedurat e vendimmarrjes për rregullat e raportimit financiar të subjekteve zgjedhore, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e financierëve të subjekteve zgjedhore, monitorimin dhe auditimin e pavarur të tyre si dhe për hetimin administrativ të informacioneve, kërkesave, propozimeve, ankesave apo

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

denoncimeve për shkelje lidhur me financimin apo shpenzimet e fushatës zgjedhore.

Znj.I.Nano: Personalisht pajtohem dhe jam e të njëjtit mendim pasi kjo është rregullore për mënyrën se si organizohen mbledhjet tona. Ndërsa ç'ka është parashikuar në pikën f duhet të jetë objekt i një vendimmarrjeje të ardhshme nga ana e Rregullatorit. Pra, ne do të miratojmë me akt rregullat për raportimin financiar. Nuk miratohen në këtë rregullore këto lloj rregullash, pajtohem. Në se nuk ka ndonjë mendim tjetër për këtë gërmë. Votojmë për heqjen e gërmës f nga pika 3 e nenit 1 të rregullores.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Neni 2. Janë Ligjet dhe parimet në të cilat mbështetet veprimtaria e Komisionit Rregullator. Sigurisht veprimtaria jonë bazohet në ligj dhe këtu nënkuptojmë së pari Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor, Kodin e Procedurave Administrative dhe akte ligjore apo nënligjore që lidhen me veprimtarinë e Rregullatorit. Ndërkohë për parimet kolegët kanë ndonjë diskutim për pikën 2 për parimet?

Znj.H.Vukaj: Sikundër ju renditët burimet e së drejtës që ka lidhje veprimtaria jonë, atëherë do të thoja në përshtatje të rishikohet pika 2, e cila duhet formuluar "veprimtaria e Rregullatorit bazohet në parimet kushtetuese e në parimet e parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe në Kodin e Procedurave Administrative". Pa renditur specifikisht apo shkurtuar rendin e parimeve, pasi parimet janë të shumta, nuk janë vetëm katër apo pesë parime të Kodit të Procedurave Administrative,

**Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

kësaj i është referuar administrata ndoshta duke pas parasysh parimin e pavarësisë. Se po të shohësh mungon parimi i ligjshmërisë i cili është “a” nga ku burojnë apo marrin jetë parimet e tjera.


Znj.I.Nano: Ndonjë diskutim tjetër në lidhje me nenin 2?

Z.M.Çakaj: Në fakt kisha unë një riformulim tek pika 1. Thjesht një fjali që lidhet komplet me fillimin e nenit. Pra, të bëhet “veprimtaria e Rregullatorit mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Zgjedhor, Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ligje dhe akte nënligjore të veçanta që lidhen me fushën e zgjedhjeve. Nuk kalojmë në përsëritje e lemë “me fushën e zgjedhjeve”. Ti lemë hapësirë dhe vetes që të bazohemi në çfarëdo akti ligjor dhe nënligjor që lidhet me fushën e zgjedhjeve.

Znj.I.Nano: Lidhur me propozimin tuaj zoti Çakaj, unë mendoj që jo që lidhen me “fushën e zgjedhjeve” se mund të kemi dhe një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore që lidhen me organizimin dhe funksionimin e organit dhe që mund të na prekin hera herës. Pra, po të themi “me fushën e zgjedhjeve” e kufizojmë. Po ta zgjerojmë që “lidhen me veprimtarinë e tij” dhe në këtë rast është një organ kolegjal dhe mund të ketë.. Pra, e propozuar është “ligje dhe akte nënligjore të veçanta që përfshihen në fushën e veprimtarisë së KQZ, si dhe në aktet e miratuara nga vetë KQZ”. Propozimi im është “ligje dhe akte nënligjore të veçanta që lidhen me veprimtarinë e tij”. Propozimi i zotit Çakaj është që “lidhen me fushën e zgjedhjeve”.

Z.M.Çakaj: Mund t’i integrojmë të dyja.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Me fushën e zgjedhjeve i ngushton.

Z.M.Çakaj: Nuk kemi punë me Kodin e familjes, me fushën e zgjedhjeve është..

Znj.I.Nano: Nesër, apo dhe sot që po flasim, mund të ketë shumë akte ligjore në fuqi që afektojnë veprimtarinë e një organi si ne.

Z.I.Celibashi: Më falni, a mund të bëj një ndërhyrje?

Znj.I.Nano: Po faleminderit!

Z.I.Celibashi: Sa kohë që edhe ju nuk e keni definuar se si do të jetë zhvillimi i mbledhjes për mënyrën se si ndërhyjnë palët e treta, përfshirë dhe rastin e Komisionerit, apo dhe administratës së KQZ-së. Unë mendoj se kështu siç është, është në rregull, sepse ne flasim për ligje dhe akte nënligjore të veçanta që përfshihen në fushën e veprimtarisë së KQZ-së. Qoftë Rregullatori, qoftë Komisioneri, qoftë KAS-i nuk del dot jashtë fushës së veprimtarisë së KQZ-së. Fusha e veprimtarisë së KQZ-së është e përcaktuar. Kjo e përfshin dhe shqetësimin e zotit Çakaj dhe..

Z.M.Çakaj: Problemi i riformulimit ishte vetëm “si dhe në aktet e miratuara nga KQZ”. Pra ideja është që duke qenë se ligjvënësi i ka ndarë qartë kompetencat e Kryekomisionerit dhe kompetencat e Rregullatorit, dakord me riformulimin “në fushën e veprimtarisë ose të zgjedhjeve, ose të KQZ-së, por pjesa e fundit mund të na krijojë pak problem. Pra mund të themi “si dhe nga aktet e miratuara nga

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Rregullatori”. Meqenëse këtë atribut ligjvënësi ja ka caktuar Rregullatorit. Këtu është gjithë shqetësimi jonë.

Z.I.Celibashi: Juve nuk ju pengon askush që ta bëni atë, faleminderit!

Znj.I.Nano: Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Mua më duket më adekuate propozimi juaj e nderuar ku thuhet “lidhur me veprimtarinë e tij” e kemi përfshirë faktin që mund të ketë akte nënligjore që lidhen në tërësi me veprimtarinë e KQZ-së, sepse KQZ-ja përbëhet nga tre organe kështu që në këtë rregullore mendoj se është një akt ngushtësisht i përcaktuar, kështu që veprimtaria është e jona.

Znj.I.Nano: Po, veprimtaria është e jona, po akte ligjore dhe nënligjore që përfshihen në fushën e veprimtarisë së KQZ-së, pra në fushën e zgjedhjeve mund të jenë edhe të tjera, të mos e ngushtojmë. Atëherë tek kjo pikë biem dakord me formulimin që sapo thamë dhe tek pika 2 me propozimin e zonjës Vukaj lidhur me parimet?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Kreu II Përbërja dhe kompetencat e Komisionit Rregullator

Neni 3

Përbërja e Komisionit Rregullator është ajo e parashikuar në Kodin Zgjedhor. Kompetencat e Komisionit Rregullator gjithashtu janë të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Të gjitha kategoritë e akteve që shqyrton dhe miraton rregullatori dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

madje dhe dy mënyrat e vënies në lëvizje nga Komisioneri dhe administrata e KQZ-së, apo dhe nga çdo anëtar. Ndërkohë po në këtë nen parashikohet edhe shumica që ligji parashikon në fakt, për miratimin e vendimeve të cilat sikundër e dimë është 4:1, përveç dy vendimmarrjeve që kodi parashikon si 3:2. Po zoti Çakaj!

Z.M.Çakaj: Atëherë, te neni 3 dhe 4. Neni 3 përcakton përbërjen e Komisionit Rregullator, ndërsa neni 4 kompetencat e Komisionit Rregullator. Te pika 2 e nenit 4 parashikohet “Rregullatori funksionon me kohë të pjesshme dhe e ushtron veprimtarinë në mbledhje publike, të cilat thirren nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Unë mendoj se pika 2 e nenit 4 të bëhet pika 2 e nenit 3. Pra, përbërja dhe funksionimi i Komisionit Rregullator, për arsye se neni 4 në titull parashikon kompetencat e Rregullatorit. Kompetencat e Rregullatorit janë të listuara siç e ka parashikuar Kodi Zgjedhor. Unë propozoj ta kalojmë këtu, sepse në gjykimin tim nuk mund të përfshihet në kompetencat e Rregullatorit mënyra se si funksionon me kohë të plotë apo të pjesshme Rregullatori, faleminderit!

Znj.I.Nano: Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Pa kaluar te pika 2, ka diçka te pika 1 që mbetet për të diskutuar për t’u plotësuar në sinkron me çfarë ka dashur të thotë ligjvënësi dhe çfarë ka shprehur literalisht. Rregullatori është organ kompetent, thuhet për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Po t’i referohesh ligjit, Rregullatori nuk është vetëm kompetent për miratimin, por dhe për shqyrtimin, prandaj unë propozoj që pika 1 të jetë “rregullatori është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e akteve me

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave normuse për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve, referendumeve si dhe çdo proces që lidhet me zgjedhjet”. Ashtu sikundër shprehet në ligj.

Znj.I.Nano: Ndjesë, referenca juaj në cilin nen të ligjit ishte?

Znj.H.Vukaj: Neni 20 i Kodit Zgjedhor.

Znj.I.Nano: Atëherë, parashikimi i nenit 20 është pikërisht në pikën 3 të nenit 4, “Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij për” sikundër ligji e parashikon në të njejtën mënyrë dhe rregulloria në pikën 3 të nenit 4. Pra pika 3 e nenit 4, pika 4, pika 5 janë transpozimi i ligjit.


Znj.H.Vukaj: Atëherë që të mos krijojmë përplasje le të mbetet një pikë që transporton realisht atë që ka dashur të shprehë ligjvënësi në pikën 1 të nenit 20.

Znj.I.Nano: Pika 3 është ekzaktësisht siç e ka parashikuar neni 20 i Kodit Zgjedhor.

Znj.H.Vukaj: Atëherë që pika 1 të mos jetë e cinguar le të përthithet nga pika 3 dhe të zëvendësohet nga një pikë e vetme. Pra, të dalë një pikë e vetme pa krijuar përsëritje.

Znj.I.Nano: Pika 2 e nenit 4 të kalojë si pikë 2 e nenit 3..

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Dhe pika 1 dhe pika 3 të shkrihen në një dhe të bëhet transpozim drejt për drejt i nenit 20 pika 1 e Kodit Zgjedhor. Meqë pika 2 nuk ka lidhje me kompetencat e Rregullatorit dhe për të..

Znj.I.Nano: Kolegët ndonjë mendim tjetër?

Atëherë votojmë këtë propozim që pika 2 e nenit 4 të kalojësi pikë 2 e nenit 3 dhe pika1 dhe 3 në fund të fundit të shprehen me fjalët e ligjit.. parashikimet e nenit 20.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Neni 5. Të drejtat e anëtarit dhe kryetarit të Rregullatorit janë tre paragrafë. Në paragrafin e parë janë të drejtat e Kryetarit.

- a. cakton datën dhe orën e fillimit të mbledhjes;
- b. merr masat të koordinojë me Komisionerin për ambientet dhe krijimin e logjistikës së nevojshme për zhvillimin e mbledhjeve, transmetimin e tyre në kohë reale;
- c. merr masa për njoftimin e anëtarëve të Rregullatorit, përfaqësuesve të partive politike parlamentare, subjekteve zgjedhore dhe personave të tretë sipas rastit;
- d. drejton mbledhjet e Komisionit sipas rregullave të përcaktuara në këtë rregullore si dhe në ligjin për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike;
- e. merr masa për përcjelljen e vendimeve administratës së KQZ-së për të vijuar me procedurata administrimit dhe publikimit të tyre. Kemi ndonjë gjë për këtë pikë? Ose nqs ka diçka për nenin 5 në përgjithësi?

Votojmë nenin 5 kështu siç është me këtë përmbajtje.

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Kalojmë në nenin 6 “Detyrat e Kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Rregullator”
Kryetari dhe Anëtarët e Komisionit Rregullator, duhet:

- a. të mos ushtrojnë njëkohësisht detyra të tjera brenda organeve, institucioneve apo enteve, pjesë e pushtetit ekzekutiv;
- b. të zbatojnë dhe të respektojnë normat e njohura dhe të gjithëpranuara të etikës në komunikim dhe sjellje. Në se nuk kemi ndonjë diskutim për këtë nen e votojmë?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Neni 7 Administrata e KQZ-së

Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave që burojnë nga Kodi Zgjedhor, Komisioni Rregullator asistohet nga administrata e KQZ-së. Ndonjë propozim apo diskutim në lidhje me këtë nen?

Znj.H.Vukaj: Propozoj që pas fjalës Komisioni Rregullator të shtohet fjala mbështetet dhe asistohet nga administrata e KQZ-së.

Znj.I.Nano: Unë jam dakord me këtë propozim, kolegët? Propozim tjetër?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Kalojmë tek Kreu III Përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore.

Neni 8. Regjistrimi në KQZ i përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore. Në fakt këtu kemi pasë parasysh nenin 26 të Kodit Zgjedhor i cili në titull gjithashtu është

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

“përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore”. Po t’i hyjmë leximit të pikës 1 të këtij neni flitet jo vetëm për përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, por edhe për përfaqësuesit e partive parlamentare. Për sa kohë subjektet zgjedhore ende nuk janë regjistruar sipas Kodit. Në momentin që do të vijë afati do të regjistrohen dhe marrin cilësinë e subjekteve zgjedhore. Ky nen ka të bëjë me mënyrën e regjistrimit në KQZ. Janë mënyra që janë parashikuar dhe më herët, pra janë procedura të hershme dhe regjistrimi i përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore në KQZ. Kemi parasysh përfaqësuesin dhe zëvendësit e tyre, paisjen me autorizim apo prokurë të posaçme nga drejtuesi i partisë politike apo i subjektit zgjedhor që përfaqëson dhe mbajtien e një regjistri me të dhënat e tyre dhe përditësimin. Nuk e di nëse ka ndonjë diskutim për këtë nen? Thjesht këtë nen e përmendim sa herë na duhet për t’u referuar subjekteve themi “subjektet e parashikuara në nenin 8 pika 1 duke i përfshirë të dy grupet e subjekteve. Qoftë subjektet zgjedhore kur ta marrin këtë cilësi, qoftë partitë parlamentare në referim të nenit 26 pika 1 të Kodit Zgjedhor. Sapo fola dhe për aktin e përfaqësimit kemi ndonjë gjë? Jeni dakord me nenin 8 dhe 9 siç janë prezantuar?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka


Neni 10. Të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore dhe të partive parlamentare në Rregullator. Ndoshta e vendosim gjatë mbledhjeve sepse veprimtaria jonë ushtrohet vetëm në mbledhje. Jemi dakord?

Kemi ndonjë propozim apo koment në lidhje me nenin 10? E votojmë nenin 10 me këtë përmbajtje?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Kundër: S'ka

Kalojmë tek Kreu IV. Mbledhjet e Komisionit Rregullator. Neni 11. Thirrja, njoftimi dhe përgatitja e mbledhjes. Pra, tani hyjmë në rregulla më të detajuara të thirrjes së mbledhjes dhe më tej. Ndonjë propozim, prezantim, pyetje? Po zoti Celibashi!

Z.I.Celibashi: E vërteta është që dhe bashkë me kolegë të tjerë të stafit të KQZ-së kemi qenë në një diskutim, po dhe me ju kur na është dhënë rasti në mënyrë informale, në lidhje me formëzimin e njoftimit, apo thirrjes së mbledhjes nga Komisioneri. Meqenëse Kodi Zgjedhor ka përcaktuar tre lloj aktesh mbi të cilat ose sipas të cilave duhet të operojë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ideja ka qenë që vendimi mund të ishte akti për të thirrur mbledhjen. Në fakt nuk është Komisioneri ai që vendos për të zhvilluar mbledhjen. Akti i Komisionerit ka për qëllim, për këtë, por dhe për të sqaruar këdo tjetër të tretë jashtë këtij diskutimi, ka për qëllim thjesht dhe vetëm të vërë në dijeni Rregullatorin mbi një çështje të caktuar të cilën Komisioneri mendon që është atribut i Rregullatorit për ta shqyrtuar. Pra, nuk është se Komisioneri është ai që e thërret dhe vendos se kur do të jetë data, ora e mbledhjes. Kjo është një çështje që është atribut i vetë Rregullatorit. Thënë këtë ndoshta dhe për Komisionerin nuk ka asnjë problem në se thjesht e lemë literalisht të shkruar që Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve e thërret, ose e njofton, ose ve në dijeni Rregullatorin mbi çështje të cilat mund të jenë objekt i shqyrtimit nga Rregullatori. Dua të them se çfarë është shkruar në draft thjesht ka qenë një formulim i rastit, por që dhe ne vetë jemi në këtë diskutim dhe këtë dilemë, për aktin, apo se si do të jetë forma e tij sipas të cilit Komisioneri e thërret mbledhjen, faleminderit!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Faleminderit, kolegë në lidhje me nenin 11, po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Faleminderit, ajo që dhe vetë Komisioneri vuri në dukje, është mëse evidente të paktën tek neni 11, pjesa ku është normuar, ose mënyra e aktit me vendim mund të hiqet dhe ta lemë “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ve në lëvizje mbledhjet e Rregullatorit”. Pastaj hajde të definojmë pjesën... dhe kjo akti i thirrjes mbase kërkon një rregullim dhe të mbetet thjesht “njoftimi i mbledhjes”.

Znj.I.Nano: Zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Komisioneri me të drejtë i parapriu si jurist me eksperiencë në fushë e duke pas merakun e asaj që unë citova fillimisht, të pavarësisë së ruajtjes së pavarësisë. Komisioneri bëri një sqarim, por në kuadër të kësaj pavarësie dhe të asaj çfarë ne ushtrojmë si veprimtari, do të doja që fjala thirrje të përshtatej, ose akti i thirrjes të përshtatej me një “akt shkresor për thirrjen”. Që të jemi në kushte të përputhura me Kodin e Procedurave Administrative dhe njëkohësisht të mos krijojmë imazhin e një ndërhyrje të detyruar apo imperative tek veprimtaria që do të duhet të ushtrojë Komisioni Rregullator.

Z.M.Çakaj: Mund t’i rimë më strikt kodit dhe të themi “akti i vënies në lëvizje”.

Znj.I.Nano: Në se do të jetë akt, duhet të jetë një nga ato akte që ligji parashikon për Komisionerin: vendim, urdhër, udhëzim.

Z.M.Çakaj: Atëherë, neni 19 i Kodit Zgjedhor, në pikën 1, germa “c” ka parashikuar në mënyrë të qartë dhe shteruese detyrën e Komisionerit ku paraqiten

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

çështje të kompetencës së Rregullatorit dhe e ka saktësuar “vë në lëvizje Rregullatorin”. Në rastin konkret e përkthyer në rregulloren tonë, por dhe e përkthyer qëllimin që ka pas ligjvënësi, unë mendoj se nuk ka qenë ti japë atributet Komisionerit të nxjerrë një akt. Pra, nga pikëpamja formale juridike akti ka karakter detyrues për institucionin, organin, apo personi juridik të cilit i kundërdrejtohet. Kështu që unë gjej me vend që fjala e duhur që ka pas parasysh dhe ligjvënësi të jetë thjesht “njoftim”. Pra, Komisioneri njofton ose vë në lëvizje me anë të një njoftimi rregullatorin. Pastaj është tagër e organit që ka në kompetencë shqyrtimin e kësaj çështje për të vendosur. Është atributi i kryetarit për të vendosur për datën dhe orën dhe rendin e ditës së mbledhjes dhe më pas të drejtat dhe detyrimet që parashikohen në këtë rregullore, por dhe në kod. Unë propozoj që neni 11, pika 2 të bëhet “Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ve në lëvizje Rregullatorin. Njoftimi i mbledhjes hartohet në tre kopje”. Të mos e komplikojmë gjënë, jo akt, me karakter detyrues. Kudo fjala “akti i thirrjes” të zëvendësohet me fjalën “njoftim”.

Znj.I.Nano: Ky është një diskutim edhe më i hershëm sikurse zonja Vukaj e theksoi më herët. Ne sot në fakt mbledhemi në mbledhjen e parë publike, por kemi rreth dy javë që merremi me shqyrtimin e projektaktit. Me sa vlerësoj këtu ka një propozim që në fakt lidhet thelbësisht me mënyrën e ushtrimit të kompetencës së Komisionerit për vënien në lëvizje të Rregullatorit, apo të KAS-it nesër, pasnesër, sepse i bie që këtë diskutim ndoshta do ta kemi dhe kur të miratojmë rregulloren e KAS-it. Mënyrën se si thërret aktin, apo mjetin me të cilin vë në lëvizje KAS-in Komisioneri. Ndërkohë, para pak Komisioneri e prezantoi qëndrimin e tij kështu që kemi një draft të përgatitur nga Komisioneri i cili është duke u diskutuar për nenin 11, kemi dhe një propozim për ta lënë “njoftimi i mbledhjes” jo “akti i

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

thirrjes”. Votojmë propozimin e zotit Çakaj në se Komisioneri ka diçka tjetër pas diskutimeve tona?

Z.I.Celibashi: Në se më lejohet, jam dakord me këtë zgjidhje të propozuar. Edhe vetë e thashë që është zgjidhja më e mirë dhe që ka një qasje më të mirë në raport me ligjin. Do të ishte e mjaftueshme thjesht dergimi i një shkresë ku Komisioneri vë në dijeni Rregullatorin për të shqyrtuar një “x” çështje të caktuar. Pastaj është atribut i Rregullatorit për të vendosur. Mundet Rregullatori të mos i shqyrtojë fare, është atribut i tij. Me këtë rast bie dhe formulimi i fundit akti i thirrjes/njoftimi regjistrohet në Regjistrin e akteve të KQZ-së. Duke qenë se nuk do të jetë akt nuk ka nevojë të regjistrohet por thjesht të protokollohet si një shkresë, kjo është ideja.

Znj.I.Nano: Atëherë, e votojmë nenin me këto ndryshime? Kishim variantin “akti i thirrjes” do ta lemë “njoftimi i mbledhjes”. Fjalja e dytë e pikës 1 të nenit 11 bie. Pse regjistrimi... normalisht si çdo shkresë tjetër do të regjistrohet në protokoll s’kemi pse ta vendosim në rregullore se është çështje e organizimit të KQZ-së dhe jo të Rregullatorit.

Znj.H.Vukaj: Për çështje gramatikore mbase do të ishte më mirë të thuhej “akti shkresor i njoftimit të mbledhjes”, sepse kur thua akt duket sikur ka një shprehje vullneti aty në fund, pra ka konturet e një akti të mirëfilltë administrativ.

Znj.I.Nano: E heqim fare “akti”, vetëm “njoftimi” dhe njoftimi vjen me shkresë. Pra “akti i thirrjes” kudo ku është në këtë nen...po!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.I.Celibashi: Më falni dhe njëherë se si i thonë “dy juristë, tre mendje” për ta lehtësuar më shumë diskutimin. Për analogji është rasti i akteve që përgatit Këshilli i Ministrave dhe i dërgon Kuvendit. Këshilli i Ministrave nuk e imponon Kuvendin për të disponuar Kuvendi. Thjesht i dërgon draftin, projektligjin me shkresë përcjellëse. Është atributi i Kuvendit për ta futur në rend dite, për ta organizuar vetë rendin e ditës si ta çmojë kështu që.. nqs do të ndiqet kjo analogji këtu do të ishte më e përshtatshme.

Znj.I.Nano: Meqenëse dy juristë janë pesë mendje dhe jo tre, në fakt Këshilli i Ministrave i miraton me vendim projektligjet dhe pastaj i dërgon me shkresë përcjellëse. Kështu që gjithësesi, unë mendoj se po dakordësohemi në shprehjen “njoftimi”. Aty ku kemi në të njëjtin nen “akti i thirrjes” e zëvendësojmë me “njoftimi” dhe fjalinë e fundit të paragrafit të dytë të këtij neni e heqim. Jemi dakord me këto propozime? Ta votojmë? Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Kemi diçka për të shtuar. Kopje të njoftimit të mbledhjes.., pra “Në rastet kur mbledhja nuk është vënë në lëvizje nga Komisioneri sipas nenit 19, pika “c” e Kodit Zgjedhor, kopje të njoftimit të mbledhjeve dhe të akteve sipas paragrafit të këtij neni i dërgohen paraprakisht KSHZ. Akti i nënshkruar nga anëtari propozues..” këtu tani shtohet pjesa “..regjistrohet në protokoll, dhe menjëherë i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së..” diçka formale por që kërkon të vijë më shumë sistematike se sa ...

Znj.I.Nano: Rradha është e njëjta, pra nënkupton regjistrimin në protokoll dhe dërgimin tek Sekretari i Përgjithshëm i cili pastaj merr masat për njoftimin. Pra, bëhet fjalë për vënien në lëvizje të Rregullatorit nga ana e një anëtari. Votojmë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita-DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

këto ndryshime? Këto bashkë me “kopjet e njoftimit të mbledhjes” në pikën 6, sepse këtu rradha është e njejtë: regjistrim në protokoll, Sekretari i Përgjithshëm, njoftim anëtarëve të Rregullatorit..

Znj.H.Vukaj: Gjithësesi për t’i dhënë peshën e duhur...

Z.D.Çaka: Ka karakter formal në rastin kur një anëtar kërkon të vetëmblihet. Pra pikë së pari është rast përjashtimor dhe së dyti i jep karakter formal.

Znj.I.Nano: E votojmë këtë nen me ndryshimet e mbajtura shënim nga ne të gjithë deri tani dhe nga administrata besoj.

Kush është dakord me neni 11 me ndryshimet?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Kalojmë tek neni 12 bëhet fjalë për “thirrja dhe njoftimi i mbledhjes së Rregullatorit, nga caktimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar”, po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Atëherë, besoj se edhe kuptimi i titullit, por dhe përmbajtjes, propozoj të ndryshojë termi nga “caktimi i datës së zgjedhjeve” mbase “dekretimi i datës së zgjedhjeve”. Thjesht për t’i dhënë të njejtën shprehje që ka dhe Kodi Zgjedhor për çështjen e dekretimit.

Z.M.Çakaj: Dakord jam!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Në fakt neni 9 i Kodit Zgjedhor thotë “caktimi i datës së zgjedhjeve”. Në thelb asgjë nuk ndryshon. Pra, bëhet fjalë për të njëjtin moment kohor kur fillojmë e llogarisim kohën. Dekreti është mjet për caktimin e datës së zgjedhjeve. Procesi është caktimi i datës së zgjedhjeve. Neni 9 i Kodit Zgjedhor e ka caktimi i datës së zgjedhjeve për të qenë...

Znj.H.Vukaj: Për sa kohë caktimi bëhet përmes aktit formal dekret, kështu mendoj ti mbetemi propozimit të kolegut Çaka!

Znj.I.Nano: Unë jam për t’i mbetur kësaj që është propozuar që mendoj se është në përputhje me Kodin Zgjedhor. Nuk na ndryshon asgjë në thelb. Është e njëjta datë për të cilën bëjmë fjalë. Zoti Çaka, unë nenit 9 ju referova të Kodit Zgjedhor.

Z.M.Çakaj: Qëllimi i këtij neni është thirrja dhe njoftimi i mbledhjes së Rregullatorit nga caktimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar. Këtë mund ta lemë dhe kështu “caktimi” por tek pika 1, unë do të propozoja që të njëjtën gjë që tha kolegu Çaka, ta vendosim tek pika 1. Në qoftë se do t’i qëndrojmë transpozimit të nenit 9 të Kodit Zgjedhor, atëherë do të na duhet ta transpozojmë në të gjithë kuptimin. Pra, Rregullatori mbledhet sipas të gjitha afateve të përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje për periudhën nga data e dekretimit të zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Pra, të mos kalojmë në përsëritje se ç’u kuptua që thamë titullin. E bëjmë identik, fjalën dekretim që propozoi kolegu Çaka e vendosim te pika 1, jo në titull.

Znj.I.Nano: Ka propozim tjetër, votojmë propozimin e zotit Çaka, te pika 1 e nenit 12, nga “caktimi” të jetë “dekretimi i datës së zgjedhjeve”.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Neni 13. Thirrja dhe njoftimi i mbledhjes së Rregullatorit, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar. Kemi ndonjë propozim, ndonjë diskutim? Dakord?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Kalojmë tek Neni 14. Përmbajtja e dosjes së materialeve për mbledhjen e Rregullatorit. Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Propozoj që të shtohet pas fjalës rregullatori, pavarësisht se kush është thirrësi i mbledhjes së Rregullatorit, administrata e KQZ-së merr masat që materiali përkatës si rregull duhet të përmbajë. Kjo për ti dhënë peshën e duhur që dhe në rastet kur thirrësi nuk është Kryetari, por mund të jetë dhe një anëtar, apo..

Znj.I.Nano: Në fakt, unë mendoj se e ka për çdo çështje. Për çdo çështje i përfshin të dy mënyrat e thirrjes së mbledhjes. Pra, nuk ka lidhje me thirrjen e mbledhjes në vetvehte, por ka lidhje me ç'ka një çështje. Sot ne kishim vetëm një çështje në rendin e ditës dhe në këtë çështje dosja kishte, projektaktin dhe relacionin. Nesër mund të kemi 7 çështje në rendin e ditës dhe për secilën prej çështjeve do të kemi këtë dokumentacion që kemi parashikuar në nenin14.

Znj.H.Vukaj: Kam përshtypjen se detajet vetëm favorizojnë, mbështesin veprimtarinë dhe s'ka lidhje kjo që sapo thatë. Thirrësi i mbledhjes këtu është përgjithësues, pavarësisht se kush mund të jetë thirrësi i mbledhjes. Pra, edhe pse e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

fusim këtë togfjalësh, ne nuk e çenojmë formën, thjesht ne po japim një lloj kornizimi përballë detyrës së administratës për t'i konsideruar njësoj thirrësat.

Znj.I.Nano: Ndjesë, më duhet dhe njëherë të sqaroj atë që thashë. Absolutisht që është detyrë e administratës që buron nga ligji dhe nga kjo rregullore që ne po miratojmë, të mbështesë dhe të ndihmojë Rregullatorin në organizimin e çdo mbledhjeje, përfshirë këtu dhe materialet e mbledhjes. Me sa shoh në formulimin e nenit 14 në fund, bëhet fjalë për çdo çështje. Tani abstrajojmë, dalim nga fakti se kush e ka thirrur mbledhjen. Vijmë tek mbledhja e thirrur dhe tek çështjet që shqyrtohen në mbledhje. Thuhet për çdo çështje duhen këto materiale bashkëlidhur. Mendoj se nuk është vendi...


Znj.H.Vukaj: E nderuar, kjo është një dispozitë formale që edhe mund të jetë vendi dhe nuk është një dispozitë substanciale që po na cënon, apo bie ndesh me atributet e gjithësecilit të cilat mendoj se i kemi të barabarta.

Z.D.Çaka: Dakord, po këtu nuk po diskutohet kur Komisioni Rregullator është vënë në lëvizje nga Komisioneri, apo nga anëtari. Ky është parim i përgjithshëm dhe në të njëjtën mënyrë do të funksionojë.

Znj.H.Vukaj: Është një dispozitë formale që po tenton të marrë nuanca procedurale më pas në aplikim. Kjo do të thotë që nuk po ndajmë dhe po nominojmë se e kujt është, por po shtojmë këtë pjesë për t'i dhënë më shumë garanci anëtarit kur kthehet në rolin e thirrësit.

Znj.I.Nano: Që ta votojmë si propozim, ju lutem dhe njëherë propozimin?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.H.Vukaj: Propozimi përkon në një shtesë në pikën 1. Pika 1 ishte “Për çdo çështje që do të shqyrtohet në mbledhjen e Rregullatorit..” dhe unë shtoj përtej kësaj “pavarësisht se cili mund të jetë thirrësi i mbledhjes, administrata e KQZ-së merr masa që materiali përkatës si rregull duhet të përmbajë”. Nuk shoh asnjë lloj problemi.

Z.M.Çakaj: Mund të bëj një ndërhyrje të vogël. Pavarësisht se do t’i vijë pak më vonë rendi i shqyrtimit, në nenin 16 pika 1, parashikohet përgatitja e materialeve për mbledhjen që thirret nga një anëtar i Rregullatorit. Në pikën 1 parashikohet “Në rastin kur mbledhja thirret nga një anëtar i Rregullatorit, materialet e mbledhjes përgatiten nga anëtari propozues në bashkëpunim me administratën e KQZ-së e cila është e detyruar të bashkëpunojë për të respektuar afatet e njoftimit të mbledhjes sipas kësaj rregulloreje”. Propozimi i koleges shkon në sinkron dhe me parashikim e nenit 16/1.

Znj.I.Nano: Neni 16/1 përcakton posaçërisht rastin e iniciativës së një anëtari.

Z.M.Çakaj: Shkojnë të dyja në koherencë me njëra tjetrën, thjesht theksojmë faktin edhe në rast... kush është qëllimi i këtij propozimi. Besoj këtë ka dashur dhe kolegja. Edhe në rast se propozuesi për thirrjen e mbledhjes do të jetë një nga ne, një nga anëtarët e Rregullatorit, atëherë përsëri ai do të asistohet nga administrata e KQZ-së për të përgatitur projektaktin dhe relacionin.

Znj.H.Vukaj: 16/1 është nominalisht e specifikuar, kurse ky është një nen përgjithësues. Janë në koherencë me njëri-tjetrin, por le të jetë përgjithësues se do

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

të vijmë dhe në momentin kur jo gjithmonë është Kryetari ai që e thërret, por do të fusim dhe implementojmë rolin e drejtuesit. Pra, në këtë rast drejtuesi është ekuivalenti i atij që thërret, pra i thirrësit dhe jo gjithmonë i Kryetarit.

Znj.I.Nano: Ndjesë, në asnjë nen të projektregullores që është paraqitur dhe që ne e kemi shqyrtuar gjatë dy javëve nuk jemi në këtë situatë. Megjithatë do të vijmë aty pak më vonë.

Z.M.Çakaj: Besoj se ishte tjetër kund edhe ndërhyrja e koleges besoj.

Znj.H.Vukaj: Kam përshtypjen se u keqkuptuam në këtë ndërhyrje e cila është totalisht formale, nuk cënon askënd në atributet që ka.

Z.M.Çakaj: Unë parashikoj ose më saktë po të marrim titullin e nenit 14 ku parashikohet përmbajtja e materialeve të dosjes për mbledhjet e Rregullatorit, si edhe titullin e nenit 16, përgatitja e materialeve për mbledhjet që thirren nga një anëtar i Rregullatorit së pari, janë të dyja në sinkron dhe së dyti, edhe në rast se e fusim propozimin e koleges harmonizohen me njëra tjetrën. Pra, parashikojnë të dyja të njëjtin fakt edhe nqs mbledhja thirret nga një anëtar propozues do të jetë përsëri administrata e KQZ-së e cila do të asistojë në përgatitjet e materialeve të dosjes. Shkojnë në sinkron me njëra tjetrën nuk ka asnjë lloj kundërshtie në mes nenes.

Znj.I.Nano: Po zoti Celibashi!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.I.Celibashi: Në princip mendoj se ajo çfarë tha zonja Vukaj ndoshta ka nevojë të definohet, por për ta qartësuar, në rast se mund ta përdor fjalën “merak” se nuk është merak, por kjo fjalë më erdhi në mendje. Unë mendoj se tek neni 16 ndoshta mund të shtojmë diçka se literalisht këtu flitet për përmbajtjen e dosjes së materialeve për mbledhjen e Rregullatorit. Nuk ka lidhje me ndonjë aspekt tjetër. Është thjesht teknikë të shkruari dhe për ndonjë që na shikon është një “cic-mic” që nuk është thelbësor siç dhe zonja Vukaj tha. Në qoftë se do ta lini kështu, mendoj se tek neni 16 mund të precizohet më saktë në mënyrë më impenjative kjo çështje.


Znj.H.Vukaj: Nuk është aspak thelbësore dhe unë ndaj e targetova dy-tre herë këtë për të mos marrë kaq kohë, por ideja është, ndoshta fjala nuk është meraku, por ajo pjesa se çfarë mund të ndodhë kur.. pra të jepet pesha e duhur kur thirrësi është thjesht një anëtar.

Z.I.Celibashi: Po, por për teknikë të shkruari mund ta rregulloni tek neni 16, faleminderit.

Znj.I.Nano: Faleminderit, atëherë do ta votojmë nenin 14 siç e kemi dhe ndryshimin do ta kalojmë tek neni 16, zonja Vukaj që është propozuesia?

Z.I.Celibashi: Për mua, më falni dhe njëherë se po ndërhyj, për Komisionerin dhe administratën në të dyja rastet qëndron njësoj, komplet neutral, edhe pse nuk është fare çështja jonë, është çështja juaj. Thjesht për ta lehtësuar si diskutim juridik dhe në pozitën e një juristi, jo në pozitën e Komisionerit, ishte ajo çfarë thashë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.H.Vukaj: Që të mos i japim gjithë këtë peshë një dispozite të tillë, ta kalojmë tek neni 16 atë rregullimin për teknikë më specifike dhe e kalojmë këtë nenin 14, që sërish e theksoj që nuk ka peshën e një ndalese kaq të madhe.

Znj.I.Nano: Dakord, votojmë nenin 14 siç është propozuar.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Tek neni 15. Dorëzimi në Rregullator i propozimeve për ndryshime dhe shtesa në projektaktet dhe materialet e mbledhjes. Bëhet fjalë për të drejtën që kanë përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore të paraqesin propozime me shkrim apo me gojë, për ndryshime apo shtesa në projektaktet që do të shqyrtohen në mbledhjen e radhës së Rregullorit. Sigurisht që për sot s'bëhet fjalë se nuk e kemi miratuar ende rregulloren. Por sipas praktikës së deritanishme do të njoftohen sipas afateve dhe përfaqësuesit e partive politike dhe subjekteve zgjedhore për t'u përgatitur dhe për të bërë propozimet për shtesa, apo për ndryshime. Kemi ndonjë diskutim për nenin 15? E votojmë?


Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Kalojmë tek neni 16. Përveç asaj që diskutuam më herët për ta theksuar detyrimin e administratës për mbështetje, jo thjesht bashkëpunim me administratën, por mbështetje dhe asistim. Unë do të rimerrja dhe njëherë këtë shprehjen "akti i thirrjes" edhe pse këtu bëhet fjalë për thirrjen e mbledhjes nga anëtari dhe jo nga Komisioneri, të njejtën linjë duhet të mbajmë, pra njoftimi i thirrjes, sepse dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

anëtari nuk ka një akt me të cilin ndërmerr, ose ve në lëvizje Komisionin Rregullator.

Z.M.Çakaj: Në fakt unë nuk jam dakord. Atributi i anëtarit të Rregullatorit në rastin konkret që ligjvënësi i ka caktuar, që të mbledhet me kërkesë të çdo anëtari, nuk jemi në të njëjtat kushte si Komisioneri. Në rast se Komisioneri nuk e ve në lëvizje Rregullatorin, atëherë ligjvënësi i ka dhënë në mënyrë të qartë anëtarit i cili e gjykon të arësyeshme, atributin e thirrjes të mbledhjes. Në këtë rast sigurisht, si të doni mund ta quani akti i thirrjes, njoftimi ka një peshë shumë më të rëndësishme dhe shumë më të madhe se sa njoftimi që parashikon për Komisionerin.


Znj.I.Nano: Patjetër që rëndësia që i ka dhënë ligjvënësi faktit që mbledhja mund të thirret edhe nga një anëtar ose komisioni të vetëmbledhet me kërkesë të një anëtari, sigurisht që atë rëndësi që i ka dhënë ligjvënësi ne po ia japim sepse e kemi të detajuar në disa nene këtu. Për analogji po bëj këtë diskutim. Kishim në nenet pararendëse, mos gaboju në nenin 11 të rregullores ku flisim për vënien në lëvizje të Rregullatorit nga ana e Komisionerit dhe diskutimi ishte akti i thirrjes/njoftimi i thirrjes. Unë them këtë që akti i thirrjes të zëvendësohet me njoftimin.

Z.M.Çakaj: Unë propozoj që ta lemë aktin e thirrjes pikërisht se...

Znj.I.Nano: Me çfarë akti e thërres unë apo secili nga ju?

Z.M.Çakaj: Si të doni le ta quajmë, po nuk është njoftim i thjeshtë, duhet të bëjë diferencën, pastaj mbetet në gjykim dhe në vlerësim të Komisionit Rregullator e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

merr në konsideratë aktin e thirrjes së anëtarit, apo jo. Por, në vetvehte akti kur një nga anëtarët e Komisionit Rregullator e çmon se e ka në kompetencë dhe e thërret mbledhjen e Rregullatorit sigurisht që ka një vlerë shumë të madhe. Nuk mund të ketë peshën e një shkrese të thjeshtë, apo të një njoftimi.

Znj.I.Nano: Themi akti, me çfarë akti? Nesër ju si anëtar i Rregullatorit vlerësoni që kemi një çështje të fushës sonë, Komisioneri nuk na ka dërguar akte paraprakisht dhe ju vlerësoni që duhet të vetëmblihem. Me çfarë akti?


Z.M.Çakaj: Me kërkesë. Nuk është as njoftim... me kërkesë. Akti të ketë titullin kërkesë. Nuk e lëmë as njoftim, as vendim se nuk merret vendim.

Znj.H.Vukaj: Jam dakord me kolegun parafolës. Duhet ndarë momenti i aktit të thirrjes që ushtronte Komisioneri dhe ku ne u ndalëm me të drejtë dhe kërkuam korigjimin e saj në raport me aktin e thirrjes që ushtron thirrësi në rastin konkret anëtar i Rregullatorit. Për t'i dhënë peshë vullnetit të shprehur në këtë rast, të ushtruar nga thirrësi duhet të marrë vlerën e përtej një akti të thjeshtë formal, i cili mund të jetë një akt shkresor dhe nuk i jepet pesha e duhur. Për çdo eventualitet akti i thirrjes duhet gjetur një modus për të marrë siç përsëriti dhe kolegu Çakaj. Kërkesa e thirrjes duhet të ishte dhe adekuate.

Z.M.Çakaj: Kërkesë për t'u vetëmbledhur, jo jo kërkesë për thirrje. Kërkesë për vetëmbledhje sigurisht, si bazë ligjore sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.

Znj.I.Nano: Kërkesë për t'u mbledhur atëherë!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Po!

Znj.I.Nano: Kujt i dërgohet kërkesa? Për të vazhduar më tej me procedurën?

Z.M.Çakaj: Komisionit Rregullator dhe administratës së KQZ-së. Këtu vijmë dhe tek propozimi i zonjës Vukaj. Unë mendoj që ta riformulojmë pikën 1 për të integruar dhe propozimin që u bë pak më parë. Në rastin kur mbledhja thirret nga një anëtar i Rregullatorit, materialet e mbledhjes përgatiten.. mua nuk më qëndron “përgatiten nga anëtari propozues”. Por mendoj që “në rastin kur mbledhja thirret nga një anëtar i Rregullatorit, administrata e KQZ-së përgatit materialet e mbledhjes në bashkëpunim të ngushtë me anëtarin propozues”. Atributin e përgatitjes së materialeve të mbledhjes e ka administrata e KQZ-së. Në rastin konkret nuk do të bëjë gjithë relacionin, në rast se ka dëshirë le ta bëjë, por në rast se mund të jetë material voluminoz patjetër duhet jo “mund” të asistohet nga administrata e KQZ-së. Ka detyrimin administrata e KQZ-së të asistojë anëtarin e Komisionit Rregullator i cili do të bëjë propozimin në rastin konkret. Këtë qëllim ka pasë ligjvënësi.

Znj.I.Nano: Pra, unë do të thoja “anëtari propozues me mbështetjen e administratës” jo në bashkëpunim.

Z.M.Çakaj: Po me mbështetjen, por jo anëtari i Rregullatorit. Fjalja më pas të vazhdojë “Në rastin kur mbledhja thirret nga një anëtar i Rregullatorit, administrata e KQZ-së mbështet anëtarin propozues..

Znj.I.Nano: Në përgatitjen e materialeve..

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Po!

Znj.I.Nano: Le ta trajtojmë pak parimisht këtë moment. Vënia në lëvizje e Rregullatorit nga ana e një anëtari, ose vetëm mbledhja e Rregullatorit me kërkesë të një anëtari, ligji e ka konsideruar si një rast përjashtimor.

Z.M.Çakaj: Po!

Znj.I.Nano: Ndërkohë, ne pak më përpara folëm për afate të mbledhjes 48 orë, 24 orë, ose sa herë që është e nevojshme sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor. Tani në qoftë se unë ose secili nga ne si anëtarë të Rregullatorit duam të vemë në lëvizje Rregullatorin më së pari duhet: Komisioneri nuk ka ushtruar kompetencën e tij për ta vënë në lëvizje për çështje që kanë lidhje me veprimtarinë tonë dhe së dyti ne duhet të kemi një draft përpara. Pra, unë nuk propozoj thjesht një nga aktet që neni 20 i Kodit Zgjedhor parashikon që Rregullatori ka kompetencë që t'i shqyrtojë dhe miratojë, por unë kam një propozim konkret. Pra, në çdo rast administrata të mbështesë, të hartojë, kjo nuk vihet në dyshim, por propozimin fillestar draft-projektaktin e harton çdo njëri nga ne në rast se e ve në lëvizje. Pra, ne nuk jemi në kushtet që i themi administratës “më harto pak rregullat për raportimin financiar”. Jemi në kushtet kur ka disa afate, ka disa çështje të kompetencës sonë dhe të Komisionerit. Gjithmonë është në rastet kur Komisioneri nuk e vë në lëvizje, atëherë vetëmbledhet me kërkesën tonë.

Znj.H.Vukaj: Nuk ndaj të njejtin mendim me ju zonja Nano, por do të ndalesha tek atributet që na jep ligji si shqyrtues dhe miratues. Për sa kohë unë jam shqyrtues i

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*


akteve, nuk do të thotë që unë draftoj akte, apo jam daktilografues i akteve, kështu që në funksion të një administrate publike, të paguar nga taksapaguesit, në meritë të të cilit funksionojmë do të thotë që është ajo që i përgatit aktet fillimisht mirë apo keq dhe ne kemi propozimin tonë për ato akte. Pra ndërhyrjet janë tonat dhe autorësia është e jona dhe më pas vijueshmëria e procedurës i ndan në se ne kemi të drejtë, apo s'kishim të drejtë në ato propozime.

Znj.I.Nano: Në vijim të diskutimit të zonjës Vukaj, në se ne kemi kompetencë shqyrtimin dhe miratimin e akteve, kjo presupozon se kemi një draft përpara. Pyetja është në rastin kur e ve në lëvizje.. çdo të thotë të vesh në lëvizje Rregullatorin? Të thërrasësh një mbledhje ku të shyrtosh e të miratosh akte!

Znj.H.Vukaj: Po por jo ti përgatisësh më përpara.

Z.M.Çakaj: Atëhere, e nderuar Kryetare, në nenin 20 të Kodit Zgjedhor ku parashikohen kompetencat e Rregullatorit, pika 1 dhe pika 2 parashikon në mënyrë shteruese së pari funksionet tona pra shqyrton dhe miraton dhe së dyti llojet e akteve me karakter normativ të cilat ne bëjmë. Nuk do bëjmë shpikje këtu dhe këto lloj aktesh i ka bërë në gjithë këto vite funksionimi administrata e KQZ-së. Ka shumë të qartë ta bëjë dhe në nuk është se do të bëjmë një akt të ndryshëm nga natyra e akteve që ka parashikuar ligjvënësi, në rastin konkret ajo ç'ka mund të bëjmë neve, së pari qëllimi i ligjvënësit ka qenë në rastet kur Komisioneri nuk e vë në lëvizje, pra është një akt që është në tagër për t'u miratuar nga KQZ-ja dhe organi drejtues i saj Komisioni Rregullator, por Komisioneri nuk e ka gjykuar të arsyeshme ta vëri në lëvizje Rregullatorin, në rastin konkret më iniciativën secilit nga e anëtarët e Rregullatorit vihet në lëvizje dhe së dyti në të gjitha rastet për këto

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

akte që ka parashikuar të shqyrtohen dhe miratohen nga Rregullatori që janë të identifikuar me gërma dhe me numra në mënyrë shteruese në Kodin Zgjedhor, sigurisht që administrata e KQZ-së thjesht po kryen detyrën e saj funksionale, pra orientimin do të marrë nga ne, por nuk është se po kërkon një akt që të kërkojë administrata e KQZ-së çfarë ka në mendje anëtari i Rregullatorit. Thjesht po bën detyrën e saj.


Znj.I.Nano: Neni 20, pika 1 thotë: Rregullatori shqyrton dhe miraton projekt aktet me karakter normativ të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, që do të thotë, në momentin kur iniciativën e ka Rregullatori, njëri nga anëtarët ai përgatit një akt qoftë edhe minimal pastaj vjen mbështetja e administratës për përpunimin.

Z.M.Çakaj: Atëherë i bie të kalojmë te historia e stafit mbështetës që kanë patur ish kolegët.

Znj.I.Nano: Jo, jo të lutem. Të mos ngatërrojmë kush mbështet. Të mos ngatërrojmë, por të vendosim momentin kur administrata e KQZ-së hyn në mbështetje të një anëtari të Rregullatorit në rast se propozimi vjen nga ai. Pra edhe një herë, neni 20 thotë, “shqyrton dhe miraton” se kjo është detyra jonë aktet që i ka sjellë Komisioneri ose aktet të përgatitura nga secili nga ne. Pra kur ne e vëmë në lëvizje, një draft duhet përgatitur nga ne.

Z.M.Çakaj: Norma e parashikuar nga neni 20 pika 1 nuk e përjashton në asnjë rrethanë suportin, mbështetjen nga administrata e KQZ-së për anëtarin e Rregullatorit. Nuk e përjashton, ne thjesht po e saktësojmë këtu.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.H.Vukaj: Supozojmë se do të kemi për të përgatitur një akt voluminoz. Do të mjaftonte koha Zonja Nano për të përgatitur këtë aktin voluminoz duke marrë përsipër edhe cilësitë e një personi me veçori të spikatura në draftimin e akteve? Pra, në një kohë shumë të ngutshme dhe akti do të ishte shumë voluminoz. A do të mjaftonte koha për përgatitjen e këtij drafti edhe për të thirrur mbledhjen dhe për të organizuar dhe për të shpërndarë? Kështu që në kushtet kur administrata gëzon të drejtën dhe detyrimin e mbarjes së memories institucionale dhe duke qenë se aktet, pavarësisht se ne mund të bëjmë akte të reja, draftet ekzistojnë dhe ne do të ecim në përshtatje me ndryshimet ligjore mbi ato draftet. Edhe mund ti ndryshojmë nga e para por gjithsesi do të ecim mbi një draft të cilën e përgatit dhe e përcjell administrata. Vullneti se si do ta sinkronizojmë draftin në raport me ligjin është i yni pa diskutim, por draftin si material e përgatit administrata.

Znj.I.Nano: Nëse e përgatit administrata jemi në kushtet....

Z.D.Çaka: Neni 20 e përcakton “Të përgatitura nga administrata ose një kategori subjektësh që mund ta përgatisin ose nga anëtarët e tij”. Pra, është e ndarë kur një propozim vjen nga anëtarët dhe kur propozimi vjen nga administrata. Absolutisht pjesa e suportit është tjetër gjë.

Z.M.Çakaj: Atëherë që mos të humbasim koherencën dhe parashikimin, në rastet kur mbledhja thirret nga një anëtar i Rregullatorit, administrata e KQZ-së mbështet anëtarin propozues për të hartuar materialet e mbledhjes. Mos ta komplikojmë më shumë se duhet. Këtë ta formalizojmë në rastin konkret.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Pra fjalën “bashkëpunim” që thamë më herët do ta vendosim “mbështet”.

Z.M.Çakaj: Mbështet anëtarin propozues në hartimin e relacionit dhe të projektdraftit.

Z.D.Çaka: E kemi vendosur te neni 7 dhe me propozimin tuaj u miratua. Për funksionimin dhe përmbushjen e detyrave dhe një prej të drejtave dhe detyrave që kemi ne si anëtarë është të propozojmë akte të caktuara. Komisioni Rregullator mbështetet dhe asistohet.

Z.M.Çakaj: Neni 7 shkon në sinkron me këtë, këtu është norma që do ti referohemi në një situatë eventuale të mundshme. Domethënë në një situatë hipotetike kur do të kemi ne ndonjë paqartësi apo ndonjë mungesë të ndarjes së detyrave, ne në raport me administratën do t'i referohemi nenit specifik që është neni 16 për të rakorduar apo koordinuar detyrat.

Znj.I.Nano: Atëherë vimë më propozimin konkret ju zoti Çakaj dhe zonja Vukaj. Si është propozimi për pikën 1 le të themi?

Z.M.Çakaj: Në rast se mbledhja thirret nga një anëtar i Rregullatorit, administrata e KQZ-së mbështet anëtarin propozues për hartimin e materialeve të mbledhjes.

Znj.I.Nano: Pika 2, Materialet e mbledhjes dhe njoftimi, i hartuar sipas parashikimeve të kësaj..

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Jo njoftimi, kërkesa për thirrjen e mbledhjes. Pra, e heqim aktin e thirrjes dhe e zëvendësojmë më termin kërkesë. Kërkesa për vëtembledhje. Siç e parashikon Kodi Zgjedhor.

Znj.I.Nano: Në fakt nuk parashikon kërkesë Kodi Zgjedhor.

Z.M.Çakaj: Vetëmbledhjet thotë, i bie që të bëjë projektaktin dhe të firmosë kështu që më mirë kërkesë.

Znj.I.Nano: Problemi është që këtë kërkesë kujt ia drejtojmë? Kujt i dërgohet kërkesa?

Z.M.Çakaj: Të gjithë anëtarëve të Komisionit Rregullator. Neni 12 i ligjit pika 4 parashikon "Rregullatori funksionon me kohë të pjesshme dhe ushtron veprimtarinë në mbledhje publike të cilat thirren nga Komisioneri, në rast se Komisioneri nuk vë në lëvizje Rregullatorin ose KAS-in kur ka çështje të kompetencës së tyre atëherë organet vetëmbledhen me kërkesë të çdo anëtari.

Znj.I.Nano: Kërkesë, dakord. Në fakt ramë dakord për dy ndryshime. Këtu te pika 1 do vendosim me invers detyrimin e administratës për bashkëpunim dhe në pikën 2 kemi kërkesë për mbledhjen e Rregullatorit. Jemi dakord me këto dy propozime?


Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Faleminderit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Neni 17. Përgatitja e materialeve të mbledhjes të Rregullatorit. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe administrata e KQZ-së përgatisin materialet për çdo mbledhje të Rregullatorit dhe nënkupton të dy kategoritë e mbledhjeve për shkak të thirrësit ose propozuesit. Komisioneri përfaqëson vetë ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së projektaktin e propozuar për miratim në mbledhjen e Rregullatorit. Në çdo rast Rregullatori mund të thërrasë për shpjegime zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së. Një sqarim nga ana jonë, ne e kemi diskutuar dhe më herët. Ne e çmojmë maksimalisht faktin që sot Komisioneri ka ardhur vetë për të prezantuar edhe për të qenë i pranishëm në këtë mbledhje. Sigurisht Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së duke qenë nëpunësi më i lartë civil i administratës besojmë se do të jetë i pranishëm në të gjitha mbledhjet e Rregullatorit. Ajo ç'ka ne kemi dashur nëpërmjet këtij neni është që në çështje të caktuara në të cilat mund të ketë detaje me karakter teknik, pra projektakti që do të shqyrtohet dhe miratohet, ne do të donim edhe persona të tjerë nga administrata të cilët do të njoftohen përpara mbledhjes si drejtori IT, i logjistikës, specialistë gjithmonë rast pas rasti në varësi të projekt aktit që do të shqyrtojmë.

Z.I.Celibashi: Thjesht për ta komentuar mua më duket shumë mirë e përcaktuar që administrata e KQZ-së nuk është në shërbim të Komisionerit, apo në mënyrë të veçantë të secilës prej strukturave të tjera, por është në shërbim të çdo gjëje që lidhet me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe me përgatitjen e Zgjedhjeve. Them këtë aq më shumë dhe Rregullatori është në të drejtën e vet që nga niveli më i ulët i administratës deri tek niveli më i lartë, të ketë të drejtën për të thirrur, për të dhënë shpjegime e sqarime nga çdo anëtar i administratës. Secili prej tyre ka detyrimin për t'u paraqitur në një mbledhje të Rregullatorit për të dhënë ato shpjegime. Në fakt është shumë mirë që kjo të jetë e përcaktuar kështu.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Faleminderit! Po zonja Vukaj!


Znj.H.Vukaj: Tek neni 17, në pikën 1, në interpretim e në mbështetje të Kodit të Procedurave Administrative, për sa kohë administrata kryen rend piramidial, kryen veprimtari administrative, do të thoja të shtonim frazën “janë përgjegjës për përgatitjen e materialeve për çdo mbledhje të Rregullatorit. Jo thjesht “përgatisin materialet”.

Znj.I.Nano: Në fakt sapo e diskutuam tek neni 16. Gjithë kohën thamë përgatit, përgatit. Ligji thotë gjithashtu “përgatit”.

Z.D.Çaka: Unë mendoj se në rastin e përgatitjes së materialeve nuk bëhet fjalë vetëm për përgjegjësinë. Në qoftë se do ta normojmë në këtë rregullore përgatit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe administrata përgatisin materialet, pra në bazë të kësaj rregulloreje ata kanë marrë një detyrë dhe pastaj janë përgjegjës apo jo, mua më duket diçka e tepërt, sepse përgjegjësia është diçka jashtë..

Znj.H.Vukaj: Përgjegjësia zoti Çaka thjesht i referohet parimit të përgjegjësisë, neni 15 i Kodit të Procedurës Administrative, ku thuhet se “organet publike dhe nëpunësit e tyre mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve në përputhje me legjislacionin përkatës”. Në funksion të kësaj norme dhe veprimtarisë administrative nuk ka asgjë të keqe të shtohet fjala “mbajnë përgjegjësi”. Thjesht i jep garanci më të madhe akteve dhe rrit përgjegjshmërinë dhe sigurinë juridike të akteve që do të prodhohen.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.D.Çaka: Në momentin që do të normohet në këtë akt, përgatitja e materialeve do të jetë detyrë.

Znj.H.Vukaj: Pikërisht, detyra shoqërohet me përgjegjësi.

Z.D.Çaka: Ne nuk përcaktojmë përgjegjësitë as të Komisionerit, as të strukturave të tjera këto.

Znj.H.Vukaj: Këtë e dimë, por kjo është një veprimtari e rëndësishme prandaj shtojmë fjalën përgjegjësi. Më pas përgjegjësia zërthehet sipas nocioneve të statusit të nëpunësit civil dhe ligjit përkatës me të cilin operon administrata.

Znj.I.Nano: Në qoftë se hartimin e këtij akti do ta nisim me përcaktimin e përgjegjësive të çdo organi, çdo anëtar të Rregullatorit do të duhet ta fillonim nga vetja. Është përgjegjës për këtë, është përgjegjës për atë. Ne e kemi pas tek neni për të drejtat dhe detyrat kemi thënë, por nuk ka atë kontekst.

Znj.H.Vukaj: Zonja Nano, kam përshtypjen.. thjesht po ta lexoj unë..

Znj.I.Nano: Qoftë dhe në kuptim të gjuhës së hartimit të një akti, kur thua “ka përgjegjësi” nënkupton në çdo rast që nuk po ushtron detyrat.

Znj.H.Vukaj: Nuk kam marrë pjesë në hartimin e ndonjë Kodi Penal për të ndarë përgjegjësitë, por thjesht Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, administrata e KQZ-së janë përgjegjës për përgatitjen e materialeve. Pra, janë përgjegjës për përgatitjen e materialeve për çdo mbledhje të Rregullatorit. Pra, thjesht kornizon dhe njëherë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

garancinë juridike të procesit që do të zhvillojë Rregullatori. Kështu që nuk ka asgjë të keqe përveçse bëhet mirë.

Znj.I.Nano: T'u bëj një pyetje, çfarë përgjegjësie ka, kur themi Komisioneri dhe administrata.

Znj.H.Vukaj: Bëra një ndalesë pas zotit Çaka dhe thashë që janë përgjegjës sipas ligjeve që nënshtrohen në mënyrë të ngushtë, pra Ligjit për Statusin e Nëpunësit Civil dhe Kodit të Punës kur ndërhyt Kodi i Punës. Është piramidale pastaj për t'u ndarë në fushën e administratës.

Znj.I.Nano: Për sa i përket administratës dakord! Sa i përket Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nuk hyn as Ligji Nëpunësit Civil, as Kodi i Punës në përgjegjësitë e..

Z.M.Çakaj: Më falni, marrim një situatë hipotetike. Situata hipotetike është që Komisioni Rregullator ka diskutuar në mbledhjet e tij shqyrtuese dhe ka dakordësuar një draft paraprakisht. Ia dërgon administratës së KQZ-së për ta përgatitur siç kemi rënë dakord në nenet më parë për të përgatitur dosjen e mbledhjes dhe konstatojmë në ditën e mbledhjes që projektakti nuk përmban ato çfarë ne kemi diskutuar dhe dakordësuar. Tani a ka një nëpunës, një organ, apo një institucion përgjegjës për këtë?

Z.D.Çaka: Ne po normojmë rregullat e funksionimit të komisionit, të drejtat dhe detyrat që ka çdo anëtar, Komisioneri në raport me komisionin..

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Pjesë e punës tonë në rastin e funksionimit normal, për 90-95% e akteve që do të shqyrtojnë dhe do të miratojnë ky komision do të jenë aktet që ka hartuar dhe përgatitur edhe në respekt të detyrime të Kodit Zgjedhor, administrata e KQZ-së. kjo do të thotë që prezumohet si e mendoj unë, këto akte ne i diskutojmë dhe i shqyrtojmë në mbledhje shqyrtuese, ia nisim administratës dhe më pas ne i miratojmë në mbledhje.

Znj.I.Nano: Jo domosdoshmërisht kjo procedurë. Kjo është ekstra ligjore kjo procedurë që sapo themi.

Z.M.Çakaj: Pse është ekstra ligjore?

Znj.I.Nano: Pavarësisht se kjo është mbledhja e parë, akti i parë dhe kishim kohën e mjaftueshme. Ne sigurisht nuk do të bëjmë të njëjtën gjë. Vjen propozimi, ne shqyrtojmë, kemi vërejtje i kthejmë mbrapsh dhe pastaj na vijnë në mbledhje publike. Ne çfarë jemi duke bërë?

Z.M.Çakaj: Do të bëjmë ekzaktësisht të njëjtën gjë, por jo me afate kohore dy javë, por me afate kohore sipas Kodit Zgjedhor. Ekzaktësisht të njëjtën gjë do të bëjmë. Materialin e përgatit administrata e KQZ-së na e nis ne sipas parashikimeve në kod. Ne mblidhemi për pjesën shqyrtuese, bëjmë komente, vërejtje, sugjerime, ia ridërgojmë sipas dakordësisë apo jo, projektdraftin e rishikuar nga ne dhe ata e sjellin në mbledhjen përfundimtare. Kështu do të funksionojë. Unë po diskutoj situatën hipotetike në rast se ndodh një problem? do të ketë një nëpunës civil që do të mbajë përgjegjësi në rastin konkret? Thjesht i japim detyrën, por dhe përgjegjësinë në rastin konkret siç e ka ngarkuar dhe ligjvënësi. Kjo është për 90-

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

95% të rasteve. Në rastin kur anëtari propozue i Rregullatorit do të jetë ai që propozon thirrjen e mbledhjes dhe do të bashkëpunojë ngushtë me administratën e KQZ-së, për përgatitjen e materialeve të dosjes, atëherë është tjetër histori. Në rastin konkret, unë mendoj se propozimi i zonjës Vukaj qëndron dhe minimalisht do të duhet të implementohet në nenin 17. Përveç se ka detyrë për përgatitjen e materialeve të mbledhjes, ka dhe përgjegjësinë.

Z.D.Çaka: Detyrat ecin paralelisht dhe me përgjegjësitë, por nuk përcaktohen në këtë rregullore ne.

Znj.I.Nano: Ne përcaktojmë raportet që kemi në me administratën, nuk mund t'i ngarkojmë ne përgjegjësi Komisionerit.

Z.D.Çaka: Si një nga organet drejtuese të KQZ-së raporti i rregullatorit me administratën e KQZ-së, ka lidhje ngushtësisht dhe thelbësisht vetëm me mbledhjet dhe aktet normative që shqyrton Rregullatori. Ne nuk po evidentojmë, identifikojmë ndonjë përgjegjësi ekstra. Nuk po e ngarkojmë me detyra të tjera jashtë qëllimit dhe kompetencave që na ka caktuar ne ligjvënësi, thjeshtpër materialet e dosjeve të mbledhjes. Ne na duhet thjesht ngritja e nivelit të përgjegjësisë për materialet e mbledhjes.

Znj.I.Nano: E lexojmë dhe njëherë ju lutem pikën e parë të nenit 17. Kemi një ndarje, kemi dy subjekte. Kemi Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, kemi dhe administratën e KQZ-së. për cilën nga të dyja e kishit fjalën zoti Çakaj?

Z.M.Çakaj: E kishim fjalën ngushtësisht për administratën e KQZ-së.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Mundet dikush një formulim që ta votojmë?

Z.M.Çakaj: Ne bashkëpunojmë ngushtë me administratën e KQZ-së. Komisioneri është organi drejtues i KQZ-së. nuk ka lidhje fare, nuk kemi marrëdhënie varësie, nuk përfshihet.

Znj.I.Nano: Kemi një propozim konkret?

Z.M.Çakaj: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ngarkon administratën e KQZ-së për përgatitjen e materialeve për çdo mbledhje të Rregullatorit. Administrata e KQZ-së është përgjegjëse për përgatitjen e materialeve.

Znj.I.Nano: Propozimi i zotit Çakaj është: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ngarkon administratën e KQZ-së për përgatitjen e materialeve për çdo mbledhje të Rregullatorit. Administrata e KQZ-së është përgjegjëse për përgatitjen e materialeve.

Jemi dakord me këtë formulim?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Neni 18. Dosja e materialeve. Çfarë përmban dosja e thamë në nenin 14, këtu është vetëm çështje lëvizje brenda për brenda administratës. Ku shkon dosja, regjistrohet, protokollohet, dorëzohet, ku mbahet.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Kundër: S'ka

Neni 19. Kemi ruajtien dhe administrimin elektronik. Këtu në diskutimet paraprake kemi shtuar janë përgjegjës së bashku me drejtuesin e strukturës së Teknologjisë dhe Informacionit. Po zoti Celibashi!

Z.I.Celibashi: Formalisht e kam prezantuar unë draftin, por tani edhe duke i parë gjërat edhe shëh që ndonjë gjë mund të mos jetë e shkruar shumë mirë. Do të ishte e mjaftueshme, mendoj unë Sekretari i Përgjithshëm dhe ta heqim këtë se duket si parazite kjo “drejtuesi i strukturës së Teknologjisë dhe Informacionit”, sepse nuk e dimë se si do të jetë struktura, të mos merremi me këtë çështje. Sekretari i Përgjithshëm është maja e piramidës dhe mjafton.

Znj.I.Nano: Në qoftë se kolegët janë dakord? Atëherë Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për procesin e ruajtjes, administrimit të materialeve të mbledhjes.

Z.I.Celibashi: Mundet të shtojmë “edhe në formatin elektronik”.

Znj.I.Nano: Dakord meqenëse dhe titulli ishte “Ruajtja dhe administrimi elektronik”.

Kush është dakord?


Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Neni 20. Zhvillimi i mbledhjes së Komisionit Rregullator

1.Anëtarët e Rregullatorit paraqiten në datën dhe orën kur është njoftuar mbledhja, në sallën e mbledhjeve të KQZ-së.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

2. Në fillim të mbledhjes, Kryetari deklaroi mbledhjen të hapur, deklaroi rendin e ditës dhe anëtarët pjesëmarrës në mbledhje, drejton diskutimet, pezullon dhe mbyll mbledhjen e Rregullatorit.

3. Në periudhën 1 muaj para datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, në rast se mungon kuorumi për zhvillimin e mbledhjes, ajo shtyhet për jo më shumë se 12 orë.

4. Jashtë periudhës së përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, në rast se mungon kuorumi për zhvillimin e mbledhjes, ajo shtyhet për jo më vonë se pas tre ditësh.

5. Mbledhjet e Rregullatorit janë publike

Këtu unë kam një çështje e shtroj për diskutim, ne e kemi diskutuar dhe më herët po në çdo rast meqenëse bëhet fjalë për mbështetje teknike nga ana e administratës së KQZ-së, do të shfrytëzoja rastin që Komisioneri dhe Sekretari i Përgjithshëm janë të pranishëm në mbledhjen tonë. Sikundër e dimë jemi në kushtet e zhvillimeve të paparashikuaratë pandemisë. Zoti Çaka ka një propozim konkret.

Z.D.Çaka: Duke qenë se neni 20 është “zhvillimi i mbledhjeve të Komisionit Rregullator”, këtu bëhet fjalë për një zhvillim normal të mbledhjeve në sallë. Duke pas parasysh edhe kushtet në të cilat ndodhemi, duke shpresuar që të mos jenë më të vështira, mbase do të ishte me vend që të shtohet një dispozitë ku të bëhet një normim për mbledhjet në situata të caktuara ku do të bëhet zhvillimi i mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik. Nuk e di se sa me vend e gjejnë dhe anëtarët e tjerë. Të shtohet një dispozitë për zhvillimin e mbledhjeve në situata të jashtëzakonshme. Kam një propozim:

1. Në rastin e masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme, ose të fatkeqësive natyrore, apo të situatave të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

pandemive, mbledhjet e komisionit mund të zhvillohen edhe në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

2.Kryetari i komisionit, njofton anëtarët e komisionit dhe administratën e KQZ-së për zhvillimin në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik.

3.Në rastin e zhvillimeve të mbledhjeve në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik sipas parashikimeve të këtij neni do të respektohen për aq sa është e mundur rregullat proceduriale të parashikuara në këtë rregullore.


4.Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së merr masa për sigurimin e kushteve dhe mjeteve për zhvillimin e mbledhjes dhe komunikimin e subjekteve zgjedhore për zhvillimin e mbledhjes në distancë nëpërmjet këtyre mjeteve.

Mbase mund të ketë dhe ndonjë formulim më ndryshe, por ky është një formulim që unë bëra.

Znj.I.Nano: Zoti Çaka shkoi në propozim konkret. Pyetja ime që nxita këtë diskutim ishte. Si mendoni, a duhet të bëjmë një parashikim të tillë tani në rregullore, apo në varësi të situatës bëjmë një shtesë në rregullore? Ky është diskutimi i parë, pastaj përmbajtia e propozimit.

Z.M.Çakaj: Një diskutim të shkurtër. Pa e paragjykuar situatën se si do të vijë, unë mendoj se aktet nënligjore në fuqi, apo aktet normative do të parashikojnë mënyrën e sjelljes së gjithë administratës përfshirë mënyrën e sjelljes dhe të organeve të zgjedhura nga Kuvendi, për vijimësinë se si do të zhvillohet veprimtaria e tyre në qoftë se jemi në një situatë të caktuar. Kështu që meqenëse rregulloria e funksionimit të Rregullatorit ka të bëjë me një situatë.. dmth ajo është situatë përjashtuese. Besoj se nqs ndodhemi në një situatë të tillë do të jetë akti normativ i

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Këshillit të Ministrave që do të rregullojë mënyrën e funksionimit dhe veprimtarisë në një situatë të caktuar, nuk e dimë se si do të vijë.

Znj.I.Nano: Specifikat e mbledhjeve të organit tonë janë të ndryshme, sepse nëse ne nuk do të kishim mbledhje publike.. të qenit publike nënkupton edhe praninë e përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore, media, administrata.

Znj.H.Vukaj: E kemi diskutuar dhe më herët gjatë dy javëve të shqyrtimit mes kolegëve dhe duke qenë se pandemia po zgjat mund të kemi në referim edhe dy skenarë. Skenarin kur do të ndodhë një mbyllje totale e pakontestueshme ku do të jemi të detyruar t'i nënshtrohemi për hir të shëndetit dhe interesit më madhor në këtë rast. Skenari tjetër që mund të ketë opsionet e lëvizjes përjashtuese. Edhe në rastin tonë, ne mund t'i zhvillojmë mbledhjet këtu dhe mund të gjenden mekanizma të tjerë përmes strukturës IT, apo mekanizma të tjerë elektronikë se si mund të realizohet të qenit publik të këtyre mbledhjeve në prezencë, pra në këtë sallë. Duke ruajtur normalisht distancën mesh njëri tjetrit dhe duke marrë masat adekuatë që i përshtaten rregullimit që mund të bëjë Ministria e Shëndetësisë. Ato do të ishin rasti i fundit përjashtimor, mbledhjet e zhvilluara në distancë, apo nga shtëpia, sepse prishin në një farë mënyre ..

Z.D.Çaka: Pa dyshim që është rast përjashtimor, pastaj duhet parë se ku mund të ndodhemi nesër përpara një situatë ku dhe subjektet politike të jenë të regjistruara sa ne nuk e parashikojmë dot sot pjesëmarrjen e tyre ketu. Megjithatë mund t'ia lemë dhe kohës.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*


*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Mendoj që ky është një diskutim shumë i vlefshëm, sepse kemi disa muaj që po përballemi me një situatë të tillë dhe një pjesë e organeve publike kanë marrë masa për zhvillimin e mbledhjeve në këtë mënyrë. Një pjesë e administratës e ka zhvilluar punën on-line nga shtëpia. Po komisioneri ka fjalën!

Z.I.Celibashi: Unë mendoj që është rasti për ta trajtuar këtë si çështje. Një lloj rregullimi do të duhet të përfshihet dhe në këtë moment lidhur me këtë çështje. Kam përshtypjen se propozimi i zotit Çaka me ndonjë modifikim, të paktën për pikëpamjen time e kënaq qëllimin e këtij rasti. Ai merrte në konsideratë vetëm rastet përjashtimore kur janë të përcaktuara si të tilla nga ligji, jo në mënyrë abuzive as nga Komisioneri, as nga secili prej anëtarëve. Pra, do të jetë një rrethanë e imponuar ligjërisht dhe e identifikuar qartësisht si e imponuar e tillë. I vetmi diskutim që mbetet për të bërë këtu është ana teknike. Nqs ky protokolli teknik do të jetë pjesë e kësaj rregulloreje. Psh të themi kur është rasti që ne do ta bëjmë mbledhjen nga shtëpia, po marr rastin më ekstrem. Apo dhe secili në zyrën e vet dhe ti nuk mund të mblidhesh këtu në këtë sallë. Pra, thënë shkurt si rast të jetë i parashikuar si moment. Aty ndoshta mund të shtohen disa parime që kanë të bëjnë që në çdo rast zhvillimi i këtyre mbledhjeve në këtë formë duhet të sigurojë në transparencë, integritetin, identifikimin e qartë të subjekteve pjesëmarrëse, etj. Është mirë të përfshihet në këtë moment, ndoshta edhe ne nuk e kemi pas në vëmendje si Komisioner dhe pjesa tjetër e administratës. Me qëllim që të mos i riktheheni përsëri këtij, disa gjëra mund t'i vendosni e t'i rregulloni që tani, pastaj teknikisht e përmirësojmë. Le ta kemi si rast se mund të ndodhë nesër situata.

Z.D.Çaka: Ne vërtet mund të vijmë prezent këtu, por mbledhja nuk presupozon vetëm prezencën e trupës, por nënkupton edhe prezencën e subjekteve. Mund të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

ndodhë që ne të mblidhemi këtu, por subjektet zgjedhore, përfaqësuesit e partive politike mund të mos jenë prezent.

Znj.H.Vukaj: Këto janë modalitetet ndaj dhe zoti Celibashi ndërhyri.

Znj.I.Nano: Për çdo rast nëse ne marrim një vendim sot, kjo e le të hapur një vendimmarrje të ardhshme nesër. Edhe në propozimin tuaj ishte “në rast të situatës, 1, 2, 3, Rregullatori mund të vendosë zhvillimin e mbledhjeve në distancë. Ne sot e parashikojmë dhe unë jam shumë dakord që ne të kemi një situatë të parashikuar. Kur thotë Rregullatori mund të vendosë, në varësi të situatës që vjen merr vendimmarrjen konkrete për mënyrën konkrete të zhvillimit të mbledhjes. Me këtë rast unë do t’i bëja thirrje dhe administratës së KQZ-së, meqenëse Sekretari i Përgjithshëm ndodhet këtu që të jemi të përgatitur për çdo situatë që mund të ndodhë, nga këndvështrimi teknik.

Z.M.Çakaj: Do ta vendosim një formulim këtu ?

Znj.I.Nano: Po një formulim po me atë që tani e thamë, mund të vendosë Rregullatori, mund të vendosë të zhvillojë ... Do të jetë një pikë 6 te neni 20. Pra, deri këtu nga 1 te 5...

Z.D.Çaka: Mund të jetë edhe një nen 21 dhe se ndryshon renditjen.

Znj.I.Nano: Meqë titulli i nenit është “Zhvillimi i mbledhjes së Komisionit Rregullator” mund të jetë një pikë 6. E lexojmë edhe njëherë për ta votuar formulimin tuaj.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.D.Çaka: Realisht e kisha formuluar në formën e një dispozite të plotë me disa pika . Megjithatë, nëse Komisioni e vlerëson...

Znj.H.Vukaj: Në fakt ti nuk e di se çfarë urdhërash do të nxjerrë Ministria e Shëndetësisë.

Z.D.Çaka: Bëhet fjalë vetëm për komunikimin, për mënyrën, për marrjen e masave nga administrata e KQZ-së për zhvillimin e mbledhjes.

Znj.I.Nano: Do e lëmë me atë hapësirën ‘mund’ që ta kemi mundësinë që në varësi të situatës të vendosim konkretisht. Pra, mund të na e lexoni edhe një herë ju lutem?

Z.D.Çaka: Atëherë, nëse do të vendoset si pikë 6, mund të vendosim “Në raste të masave të jashtëzakonshme që mund të vendosen për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së fatkeqësisë natyrore apo situatave të pandemive, mbledhjet e komisionit mund të zhvillohen edhe në distancë nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik”. Ta lëmë këtë?

Znj.I.Nano: Duhet të themi pastaj “Komisioni vendos për modalitetet e zhvillimit të mbledhjes, ngarkohet administrata e KQZ-së”.

Z.M.Çakaj: Unë mendoj se duhet të vendosim një parashikim. Pra, parashikimi të jetë i natyrës së tillë : që në raste të pamundësisë objektive të zhvillimit të mbledhjeve për shkaqe të përligjura, Komisioni Rregullator mund ta zhvillojë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

mbledhjen online duke respektuar parimin e aksesit të barabartë, të transparencës, ligjshmërisë, dy-tre parime aty. Pra, kjo të jetë formulimi. Kryetari në bashkëpunim me administratën bën të mundur përgatitjen e infrastrukturës, në rastin konkret.

Znj.I.Nano: Jeni dakord me këtë propozim që të lëmë të hapur mundësinë në varësi të situatave? Jemi dakord më këtë ta vendosim si pikë të 6 të nenit 20?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Faleminderit

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Ju kërkoj ndjesë që e mora fjalën pas diskutimeve tuaja se në fakt pritet në mënyrë strikte të respektohet dhe një lloj rregulli se si do të mund të bashkëveprojmë . Duhet të komunikojë komisioni se kur do të mund të ishte e drejta e fjalës së përfaqësuesve së partive politike ose përfaqësuesve të regjistruar së subjekteve zgjedhore. Do t'ju lutem vetëm dy konsiderata të vogla se sdo të përsëris veten. Do të them se kjo vjen për shkak pikërisht së mungesës së një rregullimi të plotë të ushtrimit të drejtave nga subjektet. E pashë në tërësi të gjithë ligjin dhe çuditërisht ligji nuk e ka dhënë një definim të tillë se sa i takon për të qenë strikt në rregulla. Më lejoni të sjellë në vëmendjen tuaj dhe besoj se është në interes që shikoj që ka një shumë të gjatë këtë, po e flas nga praktika e gjatë e punës më Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Do të thoja, ndonëse kjo nuk parashikohet në ligj do të thoja që një pjesë e konsiderueshme e tyre në mbledhjet informale të anëtarëve të Rregullatorit mund të ezaurohen për dakordësi, të çështjeve të cilat nuk ka dakordësi, ka sigurisht një

Zbardhi materialin e inçizuar

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

diskutim publik, të ndërgjegjësohet edhe publiku se çfarë po ndodh dhe ku është konflikti. Ndryshe këtu do të bëhet një ekspozë, më mirëkuptoni nuk kam asnjë qëllim të keq, këtu do të bëhet e mundur që ashtu si janë bërë dikur mbledhjet ku prevalonte shumë qëndrimi politik i palëve. Dëshira për të thënë për tu përfshirë në debat, protagonizmi të pengojë mbledhjen. Së treti, do të kisha nevojë të sillja në vëmendjen tuaj një problem. Në pikën 3 me të drejtë është parashikuar rasti në mungesë të kuorumit në veprimtarinë e Komisionit. Flet edhe për një shtyrje brenda 12 orësh për të siguruar kohën. Pyetja ime është, mos do të duhet deri në fund të mbyllet procedura e mungesës së kuorumit? Çfarë ndodh pas 12 orësh, a dorëzohet projektakti apo brenda 5-7 ditësh do të rishqyrtohet edhe një herë do të përfshihet me procedurë kjo? Kjo nuk besoj që kjo ka nevojë për rregullim, nëse doni që të ezaurohet me pjesën tjetër dhe ta keni në konsideratë ju lutem se unë e kuptoj që ju menjëherë përfshiheni në diskutime. A jam i mundur që t'i ezauroj menjëherë që për gjëra që s'kam interes të mos kërkoj më ...?

Znj.I.Nano: Jemi në diskutimin nen për nen. Të mbarojmë një nen dhe pastaj... Megjithatë zoti Madhi faleminderit për ndërhyrjen tuaj. Në fakt ne si Komision Rregullator por besoj dhe Komisioneri dhe administrata gjatë hartimit të këtij projektakti kemi qenë vërtetë të shqetësuar për të mundësuar disa të drejta të fituara më herët por jot ë parashikuara aktualisht në ligjin zgjedhor dhe jemi përpjekur që të mos kemi regres kthim mbrapa dhe të parashikojmë me rregullore disa situata që lidhen me pjesëmarrjen në mbledhje, të drejtat e përfaqësuesve, apo zëvendësve të subjekteve zgjedhore apo partive politike. Në nenet në vijim ne do të diskutojmë edhe për këto çështje. Sa i përket pikës 3, neni 20 që ju përmendët nuk besoj që edhe Komisioneri edhe administrata që e kanë propozuar këtë akt dhe ne që e kemi shqyrtuar paraprakisht kemi patur parasysh që në mungesë të kuorumit

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

nuk mund të zhvillojë mbledhje dhe kjo lidhet rast pas rasti me votat e kërkuara për miratimin e një projekti. Nëse nuk ka kuorum nuk ka mbledhje, thënë me fjalë të tjera prandaj parashikohet shtyrje dhe është vendosur jo më shumë se 12 orë, mund të ndodhe pas 1 ore pas 2 orësh pas 7 orësh. Në periudha të tjera përtej kësaj është jo më vonë se 3 ditë. Nëse edhe pas 12 orësh nuk ka kuorum nuk ka kuptim fjala “shtyrje” , do të thotë që do të rimblidhet në një mbledhje tjetër. Besoj që administrata dhe Komisioneri këtë kanë patur parasysh gjatë hartimit të këtij projekt akti.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Do të më falni një minutë. Po në rast se ndodh kjo për shkak të qëndrimit të 2 apo 3 komisionerëve nuk do të arrihet kuorumi për shkak të qëndrimit të tij. Çfarë bëhet, se akti u parashtrua dhe këta nuk marrin pjesë dhe largohen dhe ngelin 2 Komisionerë. A do të vazhdohet shqyrtimi, a do të dorëzohet për shkak të mungesës së kuorumit ? Sepse ai në momentin që doli jashtë nuk ka nevojë të vazhdojë diskutimi i aktit, ky është gjithë synimi ynë.

Z.M.Çakaj: Zoti Madhi, në një situatë hipotetike kur nuk arrihet të formohet kuorum ose nuk merret vendimmarrje për shkak të mosdakordësisë së votave atëherë ligjvënësi ka parashikuar nenin 45 vijues “Të drejtën e ankimit për palët të cilat kanë interes të ligjshëm në Kolegjin Zgjedhor,” kështu që do të jetë organi epror në rastin konkret Kolegji Zgjedhor do të rregullojë, do të detyrojë me vendim edhe Rregullatorin së pari të marri vendim dhe së dyti të rregullojë paligjshmërinë apo sipas rastit kerkesën e subjektit që ka interes të ligjshëm. Ligjvënësi ka parashikuar në mënyrë shteruese të gjitha aktet normative që miraton Komisioni Rregullator dhe kuorumi përkatës dhe dy janë rastet kur miratohen me

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

shumicë të thjeshtë, gjithë rastet e tjera miratohen më shumicë të cilësuar që në mënyrë shteruese e parashikon Kodi Zgjedhor.

Znj.I.Nano: Atëherë vijojmë me votimin e nenit 20 me 2 ndryshime . Në pikën 2 jo deklaron por paraqet rendin e ditës dhe me shtesën në pikën 6 sipas propozimit të zotit Çakaj dhe të miratuar nga ne.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka


Kalojmë te neni 21. Në fakt që te një mbledhje shyruese zonja Vukaj pati një propozim. Titulli i nenit është “Rregulla të përgjithshme për pjesëmarrësit në mbledhje” dhe ka dashur të shtojë “ pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje”, pasi ka nje dallim të pjesëmarrësve në kuptimin e anëtarëve. Nëse nuk kemi ndonje diskutim në lidhje me përmbajtjen e 4 pikave të këtij neni a mund ta votojmë me propozimin e zonjës Vukaj, pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje?

Po Zoti Celibashi?

Z.I.Celibashi: Ndoshta do ishte mirë që ta lexoni paraprakisht nenin që të kuptojmë se për kë draft diskutojmë në çdo rast . Tani një pjesë iku...

Znj.I.Nano: Dakord, Rregulla të përgjithshme për pjesëmarrësit në mbledhje, neni 21. Përpara fillimit të mbledhjes, Kryetari i Komisionit Rregullator i asistuar nga personi përgjegjës i administratës së KQZ merr masa për caktimin e vendeve të pjesëmarrësve në mbledhje. Gjatë zhvillimit të mbledhjes ndalohe ndërrerja e fjalës së folësit. Ndalohet marrja e fjalës pa leje, përdorimi i celularëve dhe pirja e duhanit. Pjesëmarrësit në mbledhjet e Rregullatorit duhet të respektojnë rregullat e

*Zbardi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

etikës dhe të komunikimit. Deri tani vetëm këtë propozim kemi për pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje.

Z.I.Celibashi: Le të themi ndalohet marrja e fjalës pa leje, përdorimi i celularëve dhe pirja e duhanit, ndoshta duhet të gjejmë një formulim tjetër se mund të thotë dikush, po për të ngrënë mund të hamë, po alkol mund të pimë?

Z.M.Çakaj: E rregullon pika 4 atë të rregullat e etikës.

Znj.I.Nano: Ndonjë koment tjetër kemi ? E votojme nenin 21 me propozimin e zonjës Vukaj?


Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Dakord, Neni 22. Masat për shkelje të rregullave në zhvillimin e mbledhjes së Rregullatorit. Sigurisht përvoja ka dëshmuar por mund të jetë dhe e natyrshme që në një mbledhje të ketë problem prandaj rregullat e vendosura në këtë rast duhet të sigurohen edhe nga disa dispozita të tjera që parashikojnë masa. Pika 1, Kryetari i Rregullatorit është përgjegjës për mbajtjen e rregullit dhe siguron respektimin e kësaj rregulloreje. Kemi tre momente kur çënohen rregullat mbi zhvillimin e mbledhjes. Në rastet kur çënohen rregullat mbi zhvillimin e mbledhjes, është paraqitur dispozita deri diku e butë. Drejtuesi i saj vendos pezullimin e mbledhjes, Kryetari e kemi thënë, vendos pezullimin e mbledhjes nga 10 deri në 30 minuta. Në rast se përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, çënojnë rregullat për zhvillimin e mbledhjeve, si masë parashikohet tërheqje vëmendjeje. Në rast se ndonjë nga personat e tjerë të pranishëm në mbledhje, pra këtu bëhet dallimi ndërmjet

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

përfaqësuesve së subjekteve zgjedhore dhe personave të tjerë të pranishëm në mbledhje . Për këta të dytët Kryetari mund të vendosë largimin e tij nga salla e mbledhjeve të Rregullatorit.Unë do të thoja, te neni 3 do të bëja një propozim. Është përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, do të thoja përfaqësuesit e subjekteve të parashikuara në nenin 8, paragrafi 1, pika 1 e kësaj rregulloreje, pra që të përfshijmë edhe përfaqësuesit e partive jo parlamentare kur s'jane regjistruar si subjekte zgjedhore, neni 8 pika1.


Deri tani me pikën 1, 2, 3, dhe 4?

Z.M.Çakaj: Dakord jemi!

Znj.I.Nano: Te pika 5 më falni kemi një diskutim dhe Zoti Çakaj është përgatitur për një propozim. Në rast se zhvillimi i mbledhjes është i pamundur nw njw situatw me njw kod etike ekstreme dhe nuk është vendi në këtë rregullore të parashikojmë cilat situata diktojnë këtë përcaktim. Rregullatori është parashikuar me votim dhe pa debat, vendos shtyrjen e saj për një periudhë kohe të caktuar. Unë do të doja më përpara të pyesja hartuesit për çfarë kanë patur parasysh për këtë parashikim të pikës 5 të nenit 22.

Z.I.Celibashi: E vërteta është që dhe ne nuk kemi patur një qartësi shumë të madhe por thjesht kemi patur në vëmendje rastin kur vërtet për arsye nga më të paparashikuarat është i pamundur zhvillimi i mbledhjes edhe në këtë rast thjesht kemi thënë që ky vendim, ky propozim si të thuash për të ndaluar, për të stopuar vazhdimin e mbledhjes thjesht është një propozim dhe të vendosim pa bërë debat duhet apo s'duhet se kaosit i shtohet një kaos tjetër.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Po e qartë, faleminderit.

Z.M.Çakaj: Së pari në vijim ca parashikon neni 22. Neni 22 parashikon masat dhe parashikon një gjendje konkrete, konkretisht kur shkelen rregullat dhe masat që duhet të marrë Rregullatori apo Kryetari i Rregullatorit. Në rastin kur kemi një shkelje pra një situatë kaotike gjatë zhvillimit të mbledhjes janë në mënyrë zbritëse të renditura një, dy, tre, katër. Në rastin konkret edhe nëse pas marrjes së këtyre masave zhvillimi i mbledhjes do të ishte i pamundur atëherë ajo çfarë po propozoj unë është kjo, në rast së zhvillimi i mbledhjes pra është rezultati i gjithë situatës përshkallëzuese është i pamundur, Rregullatori vendos me konsensus për datën, orën e vazhimit të mbledhjes. Mund të shtoj edhe diçka, ndërpret mbledhjen dhe vendos me konsensus me dakordësi si të doni ju orën dhe datën. Mos ta kthejmë edhe këtë në çështje votimi se do kalojmë te votimi cilësor, është e pamundur të zhvillohet debati.

Znj.I.Nano: Situata është objektivisht e atillë që e bën të pamundur zhvillimin e mbledhjes.

Z.M.Çakaj: Kështu që Rregullatori ndërpret mbledhjen, pra pjesa e parë e fjalisë te pika 5, neni 22 qëndron, e identifikon situatën e pamundësisë së zhvillimit të mbledhjes dhe të vazhdojë “Rregullatori me konsensus..

Znj.I.Nano: Pa debat vendos..

Z.M.Çakaj: Të mos e vemë në situatë votimi këtë se pastaj do ngeçim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Pa debat vendos shtyrjen për një periudhë kohe të caktuar ose shtyrjen në një datë dhe një orë të caktuar.

Z.M.Çakaj: Do ta kërkojnë rrethanat., Rregullatori vendos me konsensus orën dhe datën e vazhimit se natyra e mbledhjes mund të jetë e tillë që kërkon vendimmarrje. S'mund ta shtyjme pafundësisht.

Znj.I.Nano: Shtyrja këtë nënkupton, që nuk kemi një mbledhje tjetër, thjesht kemi një ndërprerje prej disa orësh ose minutash, varet nga situata.

Z.M.Çakaj: Më fal, po nëse e ke në orën 11 të natës, shtyrjen do ta bësh për ditën tjetër, nëse e do rrethana kështu që e bëjmë “Vendos me konsensus për orën dhe datën e vazhimit të mbledhjes”.

Z.I.Celibashi: Ideja është jo për rastin klasik të shtyrjes por ndodh një situatë kur ndërpritet për pesë minuta ti del, qetësohen dhe kthehen njerëzit, në këtë kuptim.

Z.M.Çakaj: Por mbase nuk qetësohen për pesë minuta po për dy orë?

Z.D.Çaka: Zoti Çakaj në momentin që do të vendoset ndërprerja apo le të themi pesë minuta pushim apo 10 minuta është e përcaktuar edhe e ka zgjidhur pika 1.

Znj.I.Nano: Është pika 2.

Z.M.Çakaj: Shiko edhe në rast se mund të vazhdojë situata e nderë, mund të vazhdojë edhe më shumë se për 30 minuta, mund të ketë raste.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.D.Çaka: Po të mos vendosim norma fikse, afate kohore fikse.

Z.M.Çakaj: Jo po e lëmë të hapur, orën/datën e zhvillimit të mbledhjes.

Znj.I.Nano: Kur thua kohën je më i qetë, se kur thua datën/orën. Koha është momenti që ne do të caktojmë ndalimin e mbledhjes duke përcaktuar kohën e rifillimit të saj.

Z.M.Çakaj: Po dakord, e vërteta është se si koha, si ora, si data janë periudha kur do të vazhdojë mbledhja kështu që pak rëndësi ka kjo. Më shumë rëndësi ka që mos e hedhim në votim, hajde dakordësojmë bashkë se kjo është pamundësi objektive.

Znj.I.Nano: Pa debat, u vendos. Vendos shtyrjen e mbledhjes dhe kohën e rifillimit..

Z.M.Çakaj: Vendos me konsensus, ose dakordëson për kohën e zhvillimit të mbledhjes.

Znj.I.Nano: Kohën, le ta lëmë kohën, jo datën/orën.

Z.M.Çakaj: Po mirë kohën. Rregullatori vendos me konsensus për kohën e vazhdimin të mbledhjes.

Znj.I.Nano: Pa debat duhet ta lëmë pa debat se nuk do bëjmë debat për atë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: E njëjta gjë është, pa debat apo me konsensus.

Znj.I.Nano: Jo nuk është e njëjta gjë.

Z.M.Çakaj: Po nuk shkon pastaj, po dakordëson.

Znj.I.Nano: Pa debat është hidhet në votë pro, kundër. Me konsensus jo jo. Pa debat, ka votime pa debat pro, kundër dhe nuk them as pse pro, as pse kundër as si mendoj as çfarë mendoj. Me konsensus nënkupton dakordësinë e të gjithëve ne.

Z.M.Çakaj: Po.

Znj.I.Nano: Në çdo rast do ta bëjmë pa debat.

Z.I.Celibashi: Shtoheni pa debat, se pa debat duhet mendoj unë dhe me konsensus. Pa debat dhe me unanimitet.

Z.M.Çakaj: Po jo se ti nuk e bën dot, nuk e zhvillon dot.

Z.I.Celibashi: Se konsensusi presupozohet mund të vijë edhe nëpërmejt debatit. Ju evitoni debatin. Pa debat e me unanimitet.

Znj.I.Nano: Atëherë pa debat e me unanimitet vendos shtyrjen e saj dhe kohën e rifillimit. Jemi dakord me këtë ndryshim të propozuar?

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)


Kundër: S'ka

Sigurisht para zbardhjes dhe para nënshkrimit të aktit do t'i rishohim.

Atëhere çështja tjetër, neni 23, Diskutimi për çështje jashtë rendit të ditës. Lidhet pikërisht me disa të drejta të subjekteve zgjedhore, përfaqësuesve të partive parlamentare lidhur me mundësinë e diskutimit të çështjeve të cilat nuk janë përfshirë në rendin e ditës. Neni 23 parashikon "Në fillim të mbledhjes, pasi ka prezantuar rendin e ditës Kryetari verifikon kuorumin e nevojshëm të anëtarëve të Rregullatorit, sipas nenit 20, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Pasi kryen këto veprime, Kryetari, pyet pjesëmarrësit nëse kanë diskutime për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës duke regjistruar sipas rastit folësit. Pasi mbyllet regjistrimi i folësve, kryetari jep fjalën sipas radhës së regjistrimit. Kryetari dhe njëherë aty ku kemi thënë drejtuesi, bëhet fjalë për kryetarin. Folësit e regjistruar kanë të drejtë të flasin vetëm një herë dhe për një kohë jo më të gjatë se 5 minuta. Pas përfundimit të diskutimeve të regjistruara, asnjë prej pjesëmarrësve nuk mundet të kërkojë dhe të marrë fjalën për çështje që nuk janë përfshirë në rendin e ditës. Më lejoni meqenëse këtu kemi përfaqësues të partive politike parlamentare, të theksoj edhe një herë atë ç'ka më herët e vura në dukje, faktin që qoftë nga ana e hartuesit, Komisioneri dhe administratës, qoftë nga ana jonë që e kemi shqyrtuar paraprakisht ka qënë në vëmendje e drejta e subjekteve zgjedhore dhe partive politike parlamentare dhe mundësia që ato të përfshihen në diskutime që janë jashtë rendit të ditës. Sigurisht e normuar dhe norma që ne kemi vendosur është pesë minuta për çdo pjesëmarrës dhe jo më shumë dhe jo më shumë se një herë për të njëjtën çështje dhe më një regjistrim paraprak. Pak a shumë këto janë tre kushtet për të cilat ne kemi diskutuar. Pra, edhe një herë neni 23, për diskutimet jashtë rendit të ditës janë tre momente, regjistrimi për diskutime, pesë minuta për te folur

Zbardhi materialin e inçizuar

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

maksimumi për çdo pjesëmarrës dhe e drejta për të marrë fjalën vetëm një herë për të njëjtën çështje. Kemi ndonjë propozim ndonjën dikutim? Atëherë votojmë edhe nënin 23.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Zonja kryetare një minutë ju lutem!

Znj.I.Nano: Po!

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Këtu referon pika 1, me nenin 20, pika 3 të Kodit Zgjedhor. Unë e hap Kodin Zgjedhor dhe kjo ka të bëjë me kompetencat e kryetarit, mbase është gabim referenca nuk ndryshon neni kurrë..

Znj.I.Nano: Kjo lidhet me...neni 20 pika 3 lidhet me kuorumin

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Kjo lidhet me kompetencat e kryetarit, mbase jam unë gabim pastaj. Kjo thotë Kodi Zgjedhor dhe lidhet me kompetencat e kryetarit dhe zëvendës kryetarit.

Znj.I.Nano: Neni 20 pika 3 e Kodit Zgjedhor janë aktet administrative bazë, janë vendimet dhe vendimet merren kur votojnë së paku katër anëtarë, pra nëse ne kemi në rendin e ditës një vendim që miratohet me së paku katër anëtarë dhe nëse janë të pranishëm tre nuk mund të zhvillohet mbledhja. Kjo është verifikimi i kuorunit paraprak

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Më falni edhe një përshtypje tjetër. Po flasim para fillimit të rendit të ditës, janë diskutimet në parim. Partitë politike jashtë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

temave të rendit të ditës kanë të drejtën të ngrenë çështje të caktuara. Ti fillon ta normosh dhe s'kam asgjë mënyrën si e ke normuar. Problemi qendron që në referencën që ke bërë, neni 20 i Kodit Zgjedhor nuk përputhet se nuk është neni 20. Nuk kam gjë me përmbajtjen.

Z.D.Çaka: Është për kuorumin neni 20 pika 3.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Po pse po diskutojmë? Kompetencat e kryetarit dhe zëvendës kryetarit të KQZ-së thotë ky neni 20.

Znj.I.Nano: S'ka më kryetar dhe zëvendës kryetar KQZ-ja, mos ke kodin e vjetër atje.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Unë e di që nenet nuk ndryshojnë, u shtohen fraksione, hiqen...

Z.D.Çaka: Neni 20 është në kompetencat e Rregullatorit në Kodin Zgjedhor.

Znj.I.Nano: Është komplet i ndryshuar neni 20.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Atëhere, nuk është provokative por është pyetje e sinqertë, a është fuqizuar ky kod?

Z.D.Çaka: Ka pësuar ndryshime.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Dakord, po ndryshimet kur pësohen shënohen me fraksion.

Znj.I.Nano: Zoti Madhi, një nen mund të ndryshojë si më poshtë vijon thotë legjislatori dhe ky është rasti. Neni 20 është ndryshuar tërësisht në përmbajtjen e tij dhe në pikën 3 të këtij neni parashikohet shumica me të cilën merren vendimet dhe ne këtu jemi referuar që për shkak të shumicës së marrjes së vendimeve është i detyruar edhe kuorumi për t'u verifikuar po sipas këtij neni. Për merakun tuaj janë pikërisht ndryshimet e korrikut 2020 në Kodin Zgjedhor për shkak të të cilit jemi edhe ne këtu në këtë mbledhje, Komisioni Rregullator.

Kemi ndonjë diskutim tjetër për nenin 23?

Për shkak se është mbledhja e parë dhe ka 2 orë e 20 minuta që ka filluar vendosim 10 minuta një pushim të shkurtër.

Rifillon mbledhja e Komisionit Rregullator.

Znj.I.Nano: Rifillojmë mbledhjen pas një pushimi të shkurter. Janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Rregullatorit. E ndërprejmë mbledhjen në diskutimin e nenit 24. Radha e shqyrtimit të çështjeve në mbledhjen e Rregullatorit. Radha e shqyrtimit të çështjeve në mbledhjen e Rregullatorit është ajo e përcaktuar në rendin e ditës. Rregullatori me dakordësi mund të vendosë për ndryshimin e radhës së shqyrtimit të çështjeve në rendin e ditës. Me kërkesë të një anëtari të Rregullatorit, me votim, përfshin në rendin ditës edhe akte të tjera që plotësojnë kushtet për t'u shqyrtuar në mbledhje të Rregullatorit ose shtyrjen e shqyrtimit të një akti në mbledhjen më të afërt. Për sa u përket dy pikave të para unë mendoj që ne i kemi shteruar diskutimet. Për sa i përket pikës së tretë zoti Çakaj kishte një diskutim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Atëherë lidhur me pikën 3 të nenit 24 unë nuk jam dakord së pari me futjen e kësaj pike këtu për shkak se pikë së pari pika 3 e nenit 24 bie në kundërshtim të plotë me nenin 5 të po kësaj rregulloreje. “Të drejtat e anëtarit dhe kryetarit të Komisionit Rregullator” ku parashikohet në pikën 2 të nenit 5, parashikohet se çdo anëtar dhe kryetari i Komisionit Rregullator për ushtrimin e funksionit ka edhe këto të drejta si të kërkojë informacion apo dokumentacion nga KQZ-ja, të sigurojë nga Sekretari i Përgjithshëm kushtet e punës dhe të njihet ne rendin e ditës të mbledhjeve të Rregullatorit dhe materialet përkatëse, pika c germa i, jo më vonë se 48 orë përpara zhvillimit të mbledhjes për periudhën deri në 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve. 2, “i”, jo më vonë se 24 orë përpara për periudhën deri në 1 muaj përpara datës së zgjedhjeve, dhe 3, “i” sipas rastit jo më vonë se 2 orë përpara zhvillimit të mbledhjes për ditën e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit për çdo zonë zgjedhore. Pra, këtu kemi një kundërshtim të hapur të këtyre dy neneve. Pra pika 3 neni 24 bie në kundërshtim të plotë me parashikimet që ne kemi dakordësuar dhe kohën që duhet t’i verë ne dispozicion çdo anëtarit administrativ të KQZ-së. Pra nuk na inspiron sepse minimalisht për materialet e zgjedhjeve që duhet të shqyrtohen sigurisht kemi një dakordësi kemi një rend dite, kemi një përgatitje të çdo anëtarit për diskutime e për të gjitha, ndërkohë që nëse parashikojmë ndryshimet e rendit të ditës me votim atëherë kjo do të na sjellë në kushte jashtëzakonisht shumë të vështira. Anëtarët e tjerë minimalisht duhet të njihen me aktet dhe sigurisht të kenë kohën e nevojshme për shqyrtimin, për shtesa, ndryshime, sugjerime, apo për të dhënë mendimin e tyre dhe në fund fare për të votuar aktin që do të futet pa rradhë në rendin e ditës. Unë them ta heqim këtë, na bie në kundërshtim. Është qartazi e parashikuar në nenin 5, koha e paraqitjes së materialit dhe materialet e rendit të ditës. Dosja

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

përgatitet dhe në mbledhjet publike, ne diskutojmë ato çështje që ne kemi dakordësuar, çfarë është në rendin e ditës dhe për çfarë janë përgatitur anëtarët e Rregullatorit. Kështu që na e prish të gjithë rendin e ditës kjo. Për dy pikat e tjera jam dakord.

Znj.I.Nano: Në parim jemi shumë dakord më ju sepse këtu është paraqitur mundësia që me një kërkesë të një anëtari të shtohet në rendin e ditës një pikë dhe jam dakord që afatet nuk mundësojnë njohjen me materialet, përgatitjen e mendimeve. Ndoshta vetëm ditën e zgjedhjeve mund të na ndodhë ndonjë situatë e tillë dhe në fakt për ditën e zgjedhjeve dhe në afatet që ne kemi caktuar kemi lënë jo më shumë se 2 orë.

Z.M.Çakaj: Në pikën 5 ke një situatë eventuale që mund të ndodhi dhe kemi jo më shumë se 2 orë.

Znj.I.Nano: Pra vetëm ditën e zgjedhjeve kemi një afat jo më shumë se 2 orë. Pjesën e dytë të kësaj fjalie, shtyrjen e shqyrtimit të një akti në mbledhjen më të afërt unë mendoj që duhet t'ia lejojmë si mundësi vetes.

Z.M.Çakaj: Po është e rregulluar në të gjithë parashikimet e tjera në këtë rregullore.

Znj.I.Nano: Shtyrjen, nëse kemi 3 pika të rendit të ditës dhe një nga anëtarët thotë që e shtymë këtë pikë për 1, 2, 3, 5 arsye, shtyrja po. Futja e një pike të re në rendin e ditës nënkupton një propozim konkret, dokumentacion, material, një dosje të tërë dhe mund të jetë pamundësia e përgatitjes për diskutim të të gjithë

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

anëtarëve të Rregullatorit. Ndërsa shtyrja e shqyrtimit të një akti, e kemi në rendin e ditës dhe vlerëson pamundësinë për ta shqyrtuar në atë mbledhje, mund të shtyhet në mbledhjen më të afërt.

Z.M.Çakaj: Ka një problem këtu sepse nëse ne themi që pika 3 është bërë posaçërisht për ditën e zgjedhjeve, se atëherë mund të kemi urgjencë miratimi akti, atëherë e ka rregulluar situatën ligjvënësi.

Znj.I.Nano: Jo unë mendoj këtë, propozimin duke përfshirë dhe propozimin tuaj e formuloj në këtë mënyrë: Me kërkesë të një anëtari, Rregullatori..

Z.M.Çakaj: Po e rregullojmë te pika 2. Rregullatori me dakordësi mund të vendosë për ndryshimin e rradhës apo shtyrjen.

Znj.I.Nano: Jo, janë dy momente të ndryshme. Ndryshimi i rradhës është shqyrtimi i çështjeve ka një rëndësi më të vogël, pra do të shqyrtojmë këtë projektakt të parin dhe këtë të tretin, ndërsa shtyrja për shqyrtimin në një mbledhje më të afërt është e një rëndësie tjetër. Pra ndryshimi i rradhës nuk të prish punë brenda për brenda të njëjtit rend dite për të cilin kemi një vendim.

Z.M.Çakaj: Më fal, në mënyrën si është formuluar pika 3 neni 24 unë vlerësoj se kemi të bëjmë me akte të reja të cilat nuk janë përfshirë në rendin e ditës, apo jo?

Znj.I.Nano: Po pra janë dy momente, më lejo ta lexoj propozimin tim, nëse kënaq edhe propozimin tënd. Pikën 3 mendoj ta riformulojmë në këtë mënyrë “Me kërkesë të një anëtari, Rregullatori me votim mund të shtyjë shqyrtimin e një akti

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

në mbledhjen më të afërt”, pra shqyrtimin e një akti që e ke ndërkohë në rendin e ditës.

Znj.H.Vukaj: Po pse duhet ta bëjë këtë?

Znj.I.Nano: Mund të ketë pamundësi nga më të ndryshmet. Mund të jetë një mbledhje e tejzgjatur dhe gjithmonë akti që propozohet për t’u shtyrë në një mbledhje më të afërt nuk ka të njëjtën emergjencë të akteve të tjera.

Z.M.Çakaj: Nëse pranojmë ta vendosim këtë këtu, atëherë do të kalojmë te votimi dhe votimi do të jetë i cilësuar po nuk ka kuptim kjo.

Znj.I.Nano: Patjetër 4:1

Z.M.Çakaj: Nëse e bën më votim të cilësuar...

Znj.I.Nano: Po pra, gjithmonë është propozimi i një anëtari dhe votimi i Rregullatorit. Vetëm rastin e shtyrjes, sepse futja në rend dite unë jam shumë dakord që futja në rend ditë të një akti sot për sot krijon pamundësi për ta shqyrtuar.

Z.M.Çakaj: Pra, kuptimin e pikës 3 t’ia veshim akteve që i kemi në rend dite. Nëse e bëjmë këtë dhe vemë edhe termin votim i cilësuar jam dakord.

Znj.I.Nano: Po pra, kur themi më votim këtë kemi parasysh.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Jo, jo. Unë kam përshtypjen që duhet ta vendosim këtu, me votim të cilësuar.

Znj.H.Vukaj: Për sa kohë janë akte të rendit të ditës, do të thotë që janë akte të karakterit të kompetencës tonë dhe do të thotë që patjetër duhet ta nominosh aty se çfarë votimi është, i cilësuar apo jo i cilësuar. Ne jemi për votim të cilësuar.

Znj.I.Nano: Komisioneri kishte një mendim në mos gaboj.

Z.I.Celibashi: Në fakt po diskutoja me këshilltaren Edlirën se ka një eksperiencë recente në KQZ dhe mund të qëllojë ndonjëherë që të jetë një rast vërtet emergjent që të futet një çështje në rendin e ditës. Por, unë jam i pikëpamjes se ju duke qenë vetë ata që dispononi edhe pa e shkruar këtë në rregullore, merrni një vendim edhe vendosni për çdo gjë me shumicë të cilësuar, se dy janë rastet që ka parashikuar ligji.

Z.M.Çakaj: Po pra po, atë ç'ka parashikuar ligji e vendosim edhe këtu.

Znj.I.Nano: Besoj jemi të gjithë dakord që votimi për këtë çështje të jetë i cilësuar.

Z.M.Çakaj: Atëherë kur votimi është i cilësuar pse mos ta shkruajmë në rregullore.

Znj.I.Nano: Pra që vendimi për këto çështje të jetë i cilësuar 4 me 1, absolutisht biem dakord. Problemi është a do të lemë vetëm shtyrjen apo do të lemë mundësinë, hapësirën për shtesë?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Nëse ne vendosim votimin e cilësuar, patjetër të hapur e diskutojmë, e vendosim, dakordësojmë, për çështje emergjente.

Znj.I.Nano: Atëherë e riformulojmë, me kërkesë të një anëtari Rregullatori me votim me shumicë të cilësuar përfshin në rendin e ditës edhe akte të tjera që plotësojnë kushtet për t'u shqyrtuar në mbledhjet e Rregullatorit, ose vendos shtyrjen e shqyrtimit të një akti në mbledhjen më të afërt.

Z.M.Çakaj: Dakord!

Znj.I.Nano: *Jemi dakord, kush është pro këtij propozimi ?*

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Faleminderit, kalojmë në nenin 25. Pjesëmarrësit që kanë të drejtë të diskutojnë në mbledhjet e Rregullatorit. Në mbledhjet e Rregullatorit kanë të drejtë të diskutojnë dhe të japin mendime, vetëm anëtarët e Rregullatorit, dhe sipas rastit, përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuar në nenin 8, paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, për çështjet që ata kanë interes të ligjshëm, dhe me leje të kryetarit, pra ky është përjashtimi i parë. Përfaqësuesit, subjekte zgjedhore, parti politike, parlamentare për çështje për të cilat kanë interes të ligjshëm me leje të kryetarit. Subjekte të tjera janë administrata e KQZ-së, pjesëmarrëse në mbledhje si dhe persona të tjerë që lidhen me përgatitjen dhe administrimin e zgjedhjeve.

Nëse s'kemi ndonjë diskutim e votojmë nenin 25?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Neni 26, Shqyrtimi në mbledhjet e Rregullatorit. Shqyrtimi i akteve fillon me paraqitjen e relacionit nga Komisioneri ose Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, ndërsa në rastin kur projektakti është përgatitur nga të paktën një anëtar i Rregullatorit, relacioni paraqitet prej tij/ tyre. Relacioni paraqitet në mënyrë të përmbledhur. Pas relatimit, çdo anëtar i Rregullatorit dhe pjesëmarrësit e tjerë që kanë interes për çështjen, kanë të drejtë të bëjnë pyetje për të kërkuar sqarime, për elementë të ndryshëm të relacionit. Pjesëmarrësit që dëshirojnë të bëjnë pyetje shprehin paraprakisht kërkesën për të bërë pyetje. Kryetari i Rregullatorit, u jep së pari fjalën anëtarëve dhe më pas përcakton radhën epjesëmarrësve të tjerë për të bërë pyetje. Gjatë dhënies së përgjigjeve ndalohen ndërprerjet e fjalës të atij që përgjigjet dhe jep komentet. Me miratimin e Kryetarit pjesëmarrësit e tjerë mund të bëjnë edhe një pyetje tjetër si reagim për përgjigjen e marrë. Kemi ndonjë koment?


Z.M.Çakaj: Dakord.

Znj.H.Vukaj: Jo një moment. Kemi një problem gjuhësor te pika 1, paraqitet prej tij dhe jo prej tyre për shkak se o do të jetë një anëtar ose do të jetë Komisioneri.

Znj.I.Nano: Jo Mund të jenë edhe dy anëtarë, kur është përgatitur është të paktën një anëtar se mund të jenë edhe dy që kanë të njëjtën propozim dhe mund të jetë “prej tij/ tyre.” në varësi të faktit.

Znj.H.Vukaj: Edhe këtu te pika 2, pas relatimit, çdo anëtar i Rregullatorit dhe pjesëmarrësit e tjerë që kanë interes legjitim, ta shtojmë këtë që të jemi në sinkron me sa më lart për çështjen, kanë të drejtë të bëjnë pyetje për të kërkuar sqarime. Pra, gjithçka tjetër është në rregull përveçse interes legjitim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Ose i ligjshëm siç e kemi dhe në pikën tjetër. Dakord me këtë propozim të zonjës Vukaj?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka


Kalojmë te Kreu V, Diskutimet dhe Votimi. Votimi në parim dhe hapja e diskutimeve. Pas procedurës së parashikuar në nenin 26, kryetari propozon miratimin në parim të projektaktit nëse akti që do të miratohet është akt normativ dhe sipas rastit hap diskutimin për shqyrtimin nen për nen. Në fakt edhe pa e miratuar në këtë dispozitë të rregullores, sot faktikisht në këtë mënyrë e zhvilluam shqyrtimin e projektaktit dhe deri tani kemi votuar në parim dhe jemi në kushtet e diskutimeve nen për nen. Kryetari fton anëtarët dhe më pas pjesëmarrësit e tjerë për diskutime për projektaktin. Për nenin 27 jemi në rregull?

Z.M.Çakaj: Dakord vetëm një situatë që kemi parashikuar në rast se kryetari nuk e thërret apo drejton mbledhjen, atëherë besoj se ne e kemi parashikuar situatën thjesht si anëtari që ka thirrur mbledhjen gjithmonë në rast se kryetari mungon duhet të marrë atributet e drejtuesit.

Znj.I.Nano: Ku duhet ta vendosim, në cilin nen në cilën pikë?

Z.M.Çakaj: Kam përshtypjen që kjo i shkon parashikimit të nenit kur anëtari drejton mbledhjen me cilësinë e drejtuesit në rast se mungon kryetari ose nuk merr pjesë në mbledhje. Kjo gjë do të vlejë vetëm për dy që miratohen me shumicë të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

thjeshtë, për sa kohë se nuk u arrit kuorumi. Nuk arrihet kuroumi, quhet i pamiratur akti, gjasat janë të pakta të ndodhin.

Znj.I.Nano: E kemi te saktësuar. Atëherë për nenin për të cilin po flisnim jemi në rregull.

Kush është dakord me nenin 27?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Neni 28, Koha në dispozicion për të diskutuar për çështjen, për përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuar në nenin 8, pika 1 të kësaj rregulloreje është 8 minuta, e cila pasqyrohet në monitorët e sallës së mbledhjes. Për të njëjtën çështje, subjektet e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, kanë të drejtë të rimarrin fjalën vetëm një herë për një kohë, si rregull, jo më shumë se 3 minuta.

Z.I.Celibashi: Më falni, edhe këtu ndoshta do shtuar “jo më shumë se” 8 minuta.

Znj.I.Nano: Është jo më shumë se 8 minuta dhe le të themi se koha e replikës është jo më shumë se 3 minuta. Në përfundim të diskutimeve të subjekteve të përcaktuar në paragrafin 8, pika 1 të kësaj rregulloreje, diskutojnë anëtarët e Rregullatorit. Pas diskutimit të fundit të Kryetarit të Rregullatorit, bëhet mbyllja e diskutimeve. Jemi dakord me këto 2 korigjimet?


Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Po Zoti Madhi?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: E para unë po shpresoj shumë që veprimtaria e Komisionit Rregullator të jetë një veprimtari që është jashtë ndikimeve politike, por po ju sjell në vëmendje që praktika ka prezantuar shumë sjellje të cilat kanë prishur rregullin e funksionimit për shkak të boshllëqeve që ka pas dispozita dhe është krijuar një konflikt shumë i madh. Këtu lind nevoja që pikërisht kjo që është burimi i të gjithë debateve zhvilluar këtu, janë bllokuar dhe mbledhjet, mund të ezaurohet më një ndryshim që unë do ta propozoj sa të bëjë një përshkrim të shkurtër. Në nenin 26 në mënyrë korrekte dhe shteruese ju keni parashtruar të gjitha parashikimet që janë lidhur me shqyrtimin e relacionit. Kjo është faza e parë, prezantimi i relacionit. Ju lejohet subjekteve pjesëmarrëse vetëm të bëjnë pyetje rreth relacionit. Nuk jemi akoma në shqyrtimin nen për nen. Në fazën e dytë shkojmë të neni 27 e cila tashmë voton në parim dhe hap diskutimet nen për nen. Këtu kemi hyrë në një procedurë ndryshe nga relacioni, ke hyrë në procesin më aktiv të rolit të pjesëmarrësve. Do të kisha dëshirë të parashikoheshin dispozita këtu, ashtu si ne rastin e relacionit që e rregullojnë mjaft mirë procedurën e pjesëmarrësve të palës, kohës se kur ndërhyjnë, sepse unë kam një propozim, kam një nismë për ndryshim. Kur do ta prezantoj, para apo pasi të diskutohet neni se ju jeni në këtë rast gjykatë si të themi se do ta shqyrtoni më tutje. E dyta, kam një pikëpyetje që s'më shpreh ligji këtu. Ju thoni 8 minuta, pyetja ime është 8 minuta për çdo dispozitë që po diskutohet nga ju apo 8 minuta në mënyrë të përgjithshme të gjithë draftit? Sigurisht edhe unë edhe ju për shkak të eksperiencës e dimë se kush është përkthimi i kësaj, por ju thashë është abuzuar në mënyrë të tmerrshme. Ju lutem nuk ka asgjë për sa ju mund të parashikoni të shqyrtimi në parim, të shikoni tani procedurat nen për nen se sikur hiqet e drejta, sa ka të drejta, koha kur diskuton pjesëmarrësi dhe kur merret vendimi nga ana juaj. E fundit që do të thoja do të ishte rezultative në eksperiencën time. Po ju sjell në vëmendje një gjë,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

përgjithësisht kur futen subjekte zgjedhore ka të bëjë më nivelin e tyre profesional etj etj, invorgohen në debat edhe Komisionerët, KAS-i, Rregullatori etj etj. Do të ishte shumë e përshtatshme që qendrimi i tyre të ishte sa më i ftohtë dhe të mos përfshihen në debate paraprake. Ju përfshihen dhe vendosni në fund fare me vendimin tuaj, por pjesëmarrjen në një debat të tillë e kompromenton procesi. Ju ktheheni dhe bëheni kontradiktore me palën tjetër. Dhe njëherë po ju them, shikojeni mirë këtë, ka qenë burimi i gjithë të këqijave.

Znj.I.Nano: Tashti z. Madhi, nëse do të kishit një propozim konkret ne do ta shqyrtonim këtu, po sa i përket merakut tuaj sigurisht ne nuk mund t'ia kufizojme vetes, po as anëtarëve të KAS-it, nesër kur të miratojmë rregulloren, që të shprehen vetëm me vendim, sepse në fund të fundit për të arritur tek vendimi sigurisht që mund të ketë debat të gjerë për një nen, për një fjalë, për një fjali, kështu që jo domosdoshmërisht propozimet e subjekteve zgjedhore, minimalisht të anëtarëve të komisioneve të kalojnë thjesht dhe vetëm me votim, çdo rast duhet të..

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Zonja Kryetare pse prireni gjithmonë që të kundërshtoni këtë propozim që është shumë dashamirës. Po ju them prapë nëse një komisioner siç ka ndodh është përfshirë në një debat diskutim ka shprehur edhe qëndrimin e tij përpara se të bëhet një mbledhje. Fillimisht e kam pasur unë të drejtën për ndonjë propozim atëhere kjo e ka zgjeruar rolin e tij, nuk ka arsye pse kur ju filloni diskutimin tuaj, pasi keni marrë në konsideratë çfarë kam thënë, diskutoni hidhni poshtë bëni si të doni merrni vendim. Nëse individualisht unë do të lidhem me çdo anëtar të komisionit i cili ka bindje nuk më pyet nuk kërkon sqarime, se do të thotë kam një pyetje më sqaro një moment unë e sqaroj siç kam mendim , më jep një sqarim më të hollësishëm, atëhere jemi në rregull me rolin por

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

në qoftëse çdo komisionier e ndërton marrëdhënen që vetëm ai e di dhe është kështu kjo e ka ezauruar terësisht njëanshmërinë e mbledhjes së komisionit. Kurse sa i takon rregullimit nuk ja u bën rregullimi, po ju them vetëm kaq nuk kam propozim po deshët mos e konsideroni. Po ju them normojeni se kush e mer fjalën i pari, siç ke thënë këtu psh: e merr fjalën relatori pastaj të përfshihet këtu normoje tani a do ta marrim pas mbledhjes fjalën? Sigurisht nuk mund ta marrë fjalën pas mbledhjes së vendimit pasi hyn pasi ju kaloni nenin 28.


Çfarë të marrim propozim pra do jem unë ai që do të bëj propozimin nëse ka shtesa apo ndryshime mbi projektaktin dhe pastaj ju si ta gjykoni këtë dua unë të rregulloj.

Z.I.Celibashi: Mund të jap unë një sqarim se kush është:

Znj.I.Nano: Kreu është votimi.

Z.I.Celibashi: Ideja është kjo më sipër në rregulloren e re kemi përcaktuar që si bëhet diskutimi për çdo akt. Ka ndryshuar natyra tani dhe ju besoj e kuptoni shumë mirë .. e KQZ –së, Rregullatori është një trupë që merret thjesht dhe vetëm me miratimin e akteve dhe nuk ka atë përgjegjësinë për ekzekutim etj etj.sepsse ajo vinte në diskutim dhe në debat antërin e komisionit me përfaqësuesit e partive politike se ishte dhe rregullues dhe ekzekutues, tani ka ndryshuar kjo natyrë e para. E dyta duke qene se diskutimi bëhet në parim dhe pastaj nen për nen logjikisht ke rastin të diskutosh dhe në parim dhe nen për nen është vendosur një maksimum 8 minuta por jo domosdoshmërisht e ndan vet Kryetari dmth për diskutimin nen për nen do japë fjalën 2 minuta 3 minuta katër apo 5 minuta maksimumi i kohës është 8 minuta ky është kuptimi që të paktën i kam dhënë unë kësaj dispozite.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*


Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Zoti Celibashi, unë nuk kam vërejtje për mënyrën si ju e keni drejtuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ka pasur konflikt të tillë apo jo se nuk ka pasur. Përsëri po ju them bindjen time nga eksperiencia, këtë që ju keni rregulluar me parimin keni përcaktuar që unë kam të drejtë vetëm mbi relacionin të shprehur, të bëj pyetje ja ta lexoj unë, atëherë pas relativitetit.

Z.I.Celibashi: Koha në dispozicion për të diskutuar për çështjen mund të jetë nën diskutim diskutimi në parim.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Jemi tek pika 2 e nenit 25. Pas relativitetit bëhen pyetje për elementë të ndryshëm pas relacionit, e ke të specifikuar për elementë të relacionit, nuk kemi hyrë akoma në aktin rregullator që kanë normat. E keni vazhduar më tutje se çfarë bëhet. Tani po them hyjmë në një fazë procedurë të re, tani po miratojmë dispozitën nen për nen, nuk më ke dhënë të drejtën të jap konsideratat e mia a duhet të jem parimisht dakord, më thua vetëm kaq bëj pyetje për relacionin kaq më ke thënë ti mua. Ke të drejtë të më pengosh mua që sipas kësaj për relacionin. Kur vijmë tani nen për nen.. po kaq vështirë se ka shumë gjëra që përsërisin njëra tjetrën. Kaq e vështirë është të përcaktohet dy pika lidhur me procedurën e diskutimit se kush e merr fjalën dhe deri sa e merr se si vazhdon rregulli, se ju thashë më është ngrit komisioni dhe ka thënë “jo nuk do e diskutosh se parashikon ligji”.

Znj.I.Nano: Zoti Madhi, e gjithë ideja e këtij rregullimi lidhet me faktin që anëtarëve të Rregullatorit, ose ne si Rregullator nuk i kemi vënë kufi vetes për të përcaktuar që sa minuta do të flasë secili prej nesh. Ky minutazh është për

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

përfaqësuesit po them të subjekteve zgjedhore, të partive parlamentare, pra është 8 minuta për një çështje.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: pa mikrofon.....

Znj.I.Nano: Rendin e kemi thënë janë anëtarët pastaj të tjerët, pra anëtarët e Rregullatorit.


Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Pa mikrofon....

Znj.I.Nano: E merr përsëri fjalën anëtari i Rregullatorit. Pra, Kryetari fton anëtarët thotë neni 27 pika 2, dhe më pas pjesëmarrësit e tjerë për diskutime për projektaktin, pra rradha është e përcaktuar. Neni 27 pika 2 e rregullores dhe pastaj hapjen e diskutimeve nen për nen.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Kur hap diskutimin nuk po e përcakton se kush e hap diskutimin.

Znj.I.Nano: Rradha është e përcaktuar, jemi të qartë që është e përcaktuar anëtarët pastaj pjesëmarrësit, dhe tek neni 28 rregullohet në një mënyrë më të detajuar koha dhe një element tjetër procedural. Në përfundim të diskutimeve për subjektet për ju, diskutojnë dhe anëtarët e Rregullatorit, së pari anëtarët, pjesëmarrësit, përsëri anëtarët, dhe pas diskutimit të fundit bëhet mbyllja e diskutimeve nga ana e Kryetarit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Ti shpreh qendrimin tënd përpara unë nuk kam çfarë t'i shpreh diskutimit, t'i do marrësh të plotë propozimin tënd. T'i jep opinionin tënd pastaj do të marrim fjalën ne, për çfarë?

Znj.I.Nano: Për nenin konkret, për një fjali konkrete, për një dispozitë konkrete,

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Si është rradha e procedimeve konkrete?

Znj.I.Nano: zoti Madhi e keni fjalën për rradhën ndër subjektet që legjitimohen, apo rradhën e të gjithë pjesëmarrsvë në mbledhje.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Përfaqësuesit kanë të drejtën e propozimeve, shtesë, ndryshime etj etj. Ti po diskuton nenin 28, mua paraprakisht do më kërkosh kam propozim konkret edhe me gojë. Për shtesa kam të drejtë, për propozim, për shtesa, pastaj vazhdon diskutimi. Tek ky propozim në pikën 2 duhet të ndryshohet kjo pikë.

Znj.I.Nano: Dakord, ne nuk e kemi miratuar ende këtë.

Z.I.Celibashi: Arjan tek neni 28 pika 3 thuhet: se e kuptova të paktën se çfarë kërkoni, “në përfundim të diskutimeve të subjekteve të përcaktuara në paragrafin 8, pika 1 të kësaj rregullorje, diskutojnë anëtarët e Rregullatorit, diskutoni ju dhe pastaj diskutojnë të tjerët.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Pa mikrofon

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.I.Celibashi: Po pra kemi dy gjëra rradhën e diskutimeve të themi për një nen të caktuar, rradha e diskutimeve sipas këtij neni të përcaktuar neni 28 pika 1, është të diskutoni ju për përmbajtjen e neni të jepni opinionin tuaj dhe pastaj kalon tek Rregullatori është e shkruar.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Nuk është pra..

Znj.I.Nano: Neni 8 pika 1.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Është gjë shumë e thjeshtë për të qene racional të jemi efektiv...

Z.D.Çaka: Në momentin që diskutoni mund të bëni propozimet konkrete, diskutimi nuk do të thotë që ju bëni komente për aktin.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Jo mo ju sapo e demonstruat këtë praktike të tillë. Nuk ju vë faj juve se ky është një mentalitet. Ju filluat diskutimet bashkë tha Kryetarja neni 28 vazhduat tek neni 28 ju. Kryetarja nuk tha kanë gjë subjektet që janë pjesëmarrëse në lidhje me ndonjë propozim, kur ne themi jo vazhdoni diskutimin ju.

Znj.I.Nano: Sepse ne nuk e kemi miratuar këtë rregullore e cila të na detyrojë të zbatojmë këtë procedurë. Unë e thashë edhe në hyrje të mbledhjes që pa e miratuar këtë rregullore, do t'i referohemi disa parimeve të përgjithshme të organizimit të mbledhjeve të organeve kolegjiale. Në mbledhjen e ardhshme sigurisht që rradha, procedura, afatet, koha, mbetet për t'u parë dhe për të marrë sugjerime, kritika. Në rradhë të parë, për të zbatuar rregulloren, para se të marrim kritikën apo sugjerimet.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Në qoftë se nuk është definuar sjellja parimet tek ato që thoni ju por njerëz ekstrmistë të ngarkuar me presion politik kanë bërë tjetër se kanë gjetur boshlllek. Unë po ju them se kaq shumë u kushton xhanëm një fjali?! Po futeni more një fjali dhe pastaj ndryshon tërë rrethanat.


Znj.I.Nano: Bëj një propozim konkret të lutem dhe pastaj ne e shqyrtojmë edhe e kalojmë për votim.

Z.I.Celibashi: Atëherë nëse mund ta formulojmë kështu Arjan, se ndoshta duhet të shkruhet mirë “Anëtarët e Rregullatorit e bëjnë diskutimin në parim dhe nen për nen, pas diskutimit të përfaqësuesve të subjekteve të përcaktuar në nenin 8 pika 1. Mesa kuptova unë të njëjtën pyetje si Helga kisha dhe unë: Rradha kush flet i pari, ju thoni të flasim ne të parët dhe pastaj Rregullatori. Flasin të tretët dhe më pas anëtarët me qëllim që të mos e orientojnë diskutimin, bën sens në fakt për mua. Ideja është që të flasin përfaqësuesit siç është përcaktuar në nenin 8 pika 1 dhe pastaj flisni ju.

Znj.I.Nano: Na bie në kundërshtim me një nen më sipër kur kemi diskutuar.

Z.I.Celibashi: Minutazhin e përcaktoni ju, por ideja e Arjanit është që qoftë në diskutimin në parim, qoftë kur bëhet diskutimi nen për nen, thotë që fjalën ta marrim ne të parët 1 minutë ose dy minuta sa ta çmojë rregullatori dhe pastaj të diskutojnë anëtarët e rregullatorit. Kështu është Arjan? Nuk e ka tek koha se sa tek rradha.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Edhe rradha është e rëndësishme sepse kjo është për mbledhjen e Rregullatorit dhe të KAS-it, ku përgjegjësinë për të marrë vendim në fund të fundit, e kanë anëtarët e Rregullatorit dhe anëtarët e Kas-it, si mbas rastit. Në rastin e subjekteve zgjedhore apo përfaqësuesve të partive parlamentare janë pjesëmarrës në mbledhje dhe gëzojnë disa të drejta. Mbledhja është e Komisionit Rregullator ku marrin pjesë dhe në këtë rast i jepet e drejta sigurisht për të folur dhe në parim, për të diskutuar për çështjen duke paraqitur propozime konkrete, po mua më duket që propozimi i zotit Madhi kufizon të drejtën e anëtarëve të Rregullatorit dhe për analogji ndoshta edhe të KAS-it për të folur nen për nen për çëshjen edhe paraprakisht edhe në fund të diskutimeve.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Kjo gjë nuk ka lidhje me KAS, KAS-i do nxjerrë rregulloren e tij. Së dyti, më falni për mungesën e modestisë, unë po ju them në praktikën legjislative është motomo kjo sjellje. Në fund diskutohet, vendoset, pra bëhen propozime paraprake, është normale, ju do merrni të gjithë lëndën të diskutoni, lëndën e projektit bashkë me lëndën time dhe pastaj ju nuk ju mohon askush, nuk ju kufizon juve, vazhdoni, por jo pasi të keni diskutuar. Kur t'i ma ke tërhequr mua, ne kemi shkuar me një qëndrim të përbashkët. Se ne shqiptarët nuk e mbajmë dot gojën dhe e shprehim hapur aty qëndrimin kjo s'bën, kjo s'është. Mbase unë flas më gjatë se duhet dhe ju se kuptoni se çfarë them unë.

Znj.H.Vukaj: Për mua si ta diskutojmë në fillim, si ta diskutojmë në fund është e njëjta kohë që do shpenzohet në tërësinë e të gjithë gjësë, pra sa kohë do të marri gjëja. Kështuqë, në respekt të subjektit që ka interes, mendoj që të vihet, pastaj se si do ta rregullojmë këtë pjesën, sa strikt do të jenë me respektimin e kohës.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*


Përfaqësues i LSI: Ajo është tek qasje më shumë se sa te pjesa e rradhës. Është qasja që ne duam të dëgjohemi para se ju të jeni vendimmarrës në një çështje të caktuar dhe besoj se pjesa e nenit 27 pika 2 mund të riformulohet që kryetari relaton mbi çështjen, jep fjalën pjesëmarrësve dhe më pas Komisioni diskuton.

Znj.H.Vukaj: Përsa kohë palët e interesit dhe në një procedim administrativ i jepet e drejta që të ndërhyj me ekspertiza, me raporte apo me çfarëdo ata mendojnë, unë mendoj se nuk ka asnjë problem ta kenë rradhën të parët në proces.

Z.M.Çakaj: Shiko, në momentin që ne kemi rregulluar tek neni 27/2, që kemi rregulluar pjesën e prezantimit, prezantimin e relacionin e aktit, mëse normale duhet të ishte. Atëherë ftojmë edhe pjesëmarrësit nëse kanë vërejtje, shtesa, komente, sugjerime dhe më pas anëtarët, jemi ne vetë komisioni që thotë fjalën e fundit. Unë besoj se qëllimi i ndërhyrjes dhe i këtij propozimi të Arjanit është të mos humbasi aktualiteti i çështjes. Pra, diskutimi i pjesëmarrësve të ftuar, ka të bëjë fiks me momentin procedural të aktualitetit. Pra, pasi prezantohet relacioni, pjesëmarrësit që kanë interes të ligjshëm, ose pjesëmarrësit e parashikuar në nenin 8 pika 1, subjektet e identifikuara, jo më shumë se deri në 8 minuta. Atëherë ata bëjnë propozimin e tyre, bëjnë shtesa, vërejtje, sugjerime dhe më pas është Komisioni Rregullator i cili gjykon mbi projektaktin dhe mbi shtesa eventuale të mundshme. Jemi fiks në aktualitetin e gjësë.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Shiko, ndjesë për këmbënguljen por po ju them prap, kur flitet për parim ose diskutohet në parim, kemi të bëjmë thjesht, ka dhe qëndrime politike në parim. Pasi kalon, se këtu thotë se në parim na është shënuar e drejta vetëm për çështje elementë të relacionit mund të flas unë. Mund të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

kem edhe të drejtën në parim që të diskutoj dhe duhet të kem në parim diskutimin, se ky vjen në kundërshtim me interesin publik, por do flasim sa të duash, aq minuta sa kam, do ta godas në parim. Tani mbaruam në parim, do hyjmë nen për nen, më jepni mundësinë, referohemi një seance të Kuvendit ku Gramoz Ruçi thotë, tani nen për nen. Lexon zoti Ruçi nenin e parë. Ka propozime, shtesa dhe ndryshime?! Del njëri thotë kam unë, formulohet ndryshe.

Z.M.Çakaj: Arian, vetëm se kjo duhet rregulluar, ka një problem kjo. Kjo duhet rregulluar, sepse ne nuk mund ta lemë pambarimisht. Ne mund ta bëjmë në një rregullim të kësaj natyre që propozuesit ose pjesëmarrësit e tjerë kanë të drejtë të diskutojnë lidhur me çështje konkrete, apo nenet e projektaktit, jo më shumë se 3 minuta dhe të japin propozime konkrete.

Znj.I.Nano: Jo më shumë se tre minuta, për çdo nen, ne kemi 36 nene. Propozime e kemi thënë më sipër në rregullore, propozim me shkrim ose me gojë. Do të bëjë një ndryshim, subjekti zgjedhor "X" ka propozim dhe do ta paraqesi. Edhe në seancat e parlamentit nuk bëhen propozimet në seancë.

Z.M.Çakaj: Për të gjithë nenet. E ka bërë propozimin dhe ka dëshirë ta relatojë. Pjesëmarrësit nuk ia heq dot të drejtën.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Nuk po konsumoj kohë me konsideratat. Konsideratat e mia politike unë i dhashë tek parimi, kur dëgjova relacionin të gjitha konsideratat politike. Kur unë vij në një dispozitë dhe them duhet rregulluar pika 2, nuk ka më çështje parimesh. Une do të propozoj, sepse kam të drejtë edhe pas këtij akti, kam të drejtë o me gojë o me shkrim do ju paraqes juve. Po ta

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

paraqes me gojë propozimin tim. Kam këtë propozim. Ti mund të më thuash ik jashtë riformuloje dhe na e sjell këtu të shkruar, kështu është normale.

Z.M.Çakaj: Ky është momenti fiks i diskutimit. Pra, në parim ai është dakord që të miratohet një akt sipas kompetencës tonë, por për mënyrën e formulimit të aktit ka një formulim konkret. Po pra, ky është momenti, por vendosi minutazh. Mund ta propozoj edhe me gojë edhe me shkrim, thjesht ta normojë me minutazh se zgjat pambarimisht kjo.

Z.D.Çaka: Për të njëjtën çështje, jo më shumë se tre minuta.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: E di si është puna Arjan, ju nuk e keni këtë problem kryesor. Mund të keni 1, 2 apo 3 probleme lidhur me aktet e Rregullatorit, ju problemin kryesor e keni me KAS-in, aty duhet rregulluar në mënyrë të qartë, duhet formuluar drejtë ndërgjyqësia, do rregullohet në mënyrë të qartë procedura dhe jemi dakord me gjithë procesin.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Unë po them a ka mundësi të më dëgjoni se çfarë propozoj dhe pastaj vendos çfarë të duash ti.

Znj.I.Nano: Zoti Madhi, në nenin 15 që ne sapo kemi miratuar, thuhet..

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Dëgjo, se fillimisht kur diskutohet neni, diskutohen fillimisht propozimet që kanë ardhur, qoftë me shkrim qoftë me gojë, pastaj merr vendim Kuvendi, se nuk bëhet kështu tani.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Shqyrtimi i rradhës lidhet me formën e nenit, sepse një subjekt ka diskutime për 3 nene. Nëse për nenin 3 ka 7 subjekte që kanë propozime, rradha do të jetë sipas kërkesës që është bërë.

Z.I.Celibashi: Kam një formulim që ndoshta është ai që do Arjani, pastaj ju vendosni nëse doni ta pranoni. Gjatë shqyrtimit nen për nen e marrin fjalën për të parën, përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuara në nenin 8 pika 1, më pas anëtarët e Rregullatorit.

Znj.I.Nano: Nga cili nen mendoni ju?


Z.I.Celibashi: Tek 28. Domethënë edhe njëherë tek formulimi, “gjatë shqyrtimit nen për nen, e marrin fjalën të parët, përfaqësuesit e subjekteve të përcaktuara në nenin 8/1 dhe më pas anëtarët e Komisionit Rregullator”.

Z.M.Çakaj: Epo, i bie që të shfuqizohet pika 2 e nenit 27.

Z.I.Celibashi: Jo nuk shfuqizohet, sepse nuk ka lidhje ajo, ka lidhje me miratimin në parim neni 27. Vendoseni si të doni, por ky është formulimi i Arjanit.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Zonja Kryetare po ju bëj prap një sqarim tjetër, edhe nëse unë e kam bërë propozimin me shkrim. Ju lutem, unë nuk jam i pranishëm në këtë mbledhje, propozimin e kam. Ju keni detyrimin, ose duhet të dalë detyrimi që kur të vijë diskutimi në nenin 28 të thoni pika 1 është formuluar kështu, ka ardhur një propozim se mund të mos jetë prezent subjekti edhe pastaj fillon diskutimi juaj. Se unë nuk jam këtu, por unë jam gjithmonë i lirë që pasi kam

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

bërë një propozim të shpjegoj qëllimin e propozimit, të ngrihem 2 minuta, e kam bërë këtë propozim se kjo i shërben kësaj.

Përfaqësues i LSI: Arjan është parashikuar zëvendësuesi në këto raste, është parashikuar zëvendësues. Ajo do jetë gjithmonë subjektive, se mund të kemi diskutime gjatë 3 minutshit që parashikon për një subjekt zgjedhor, mund të jetë diskutim edhe nga ana juaj, ndërhyri, ose nga ana e ndonjë pjesëtari tjetër të përfshirë. Do të jetë shumë e pallogaritshme koha, si vështirë për t'u llogaritur.

Znj.I.Nano: Kështu që tre minuta flisni pa ndërprerje.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Unë nuk mund të flas sepse më ndalon ti prap për çështje që dalin jashtë diskutimit. Nuk flas dot unë, unë jam partia X dhe unë kur flet për nenin 13 që është më këtë formulim..

Diskutime pa mikrofon

Znj.I.Nano: Kjo nuk krijon problem neni 27, neni 28 është pra: e mbyllim votimin në parim ftoj anëtarët dhe pjesëmarrësit të çelimi diskutimet. Tek diskutimi nen për nen. Tek neni 28 ajo që zoti Madhi kërkon dhe ne besoj jemi duke arritur në një konsensus është që: Të ripërsërisim atë që kemi thënë në nenin 15 (të drejtën për të propozuar ndryshime e kemi thënë) ose e rregullojmë atje. Pra, jep propozimin për shtesë, ndryshim, heqje të të s'po gjej fjalën e përshtatshme..

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.H.Vukaj: Mund ta shojmë tek pika 1, dhe mund ta nisim me “rendi i diskutimeve fillon me..” tek 28 “..fillon me përfaqësuesitpikë. Koha në dispozicion ..

Znj.I.Nano: Atëherë rendi dhe koha do të jetë titulli, rendi dhe koha në dispozicion për diskutimet. Përfaqësuesit e subjekteve të parashikuara në neni 8 pika 1, sipas rradhës... sipas rradhës që ata kanë kërkuar, pra duhet të ketë një rradhë paraprake.

Z.M.Çakaj: Po rradhën e vendosim, sipas rradhës që përcaktohet nga Rregullatori.

Znj.H.Vukaj: Sipas pikës 1, rendi i diskutimeve është sipas kjo që thamë, pastaj (pikë) koha në dispozicion për të diskutuar subjekti final është jo më shumë se 8 minuta.


Znj.I.Nano: Jo më shumë se 8 minuta në total për të gjithë projektaktin.

Znj.H.Vukaj: Po për të gjithë projektaktin.

Z.M.Çakaj: Po ke diçka do ta ndryshosh atë se të bie në kundërshtim 27/2 me 28/1.

Znj.I.Nano: Problemi është se pika 2 e nenit 28 nuk duhet të qendrojë më, sepse kur flasim për diskutime për projektaktin, ne këtu ramë dakord për propozime, shtesa, ndryshime, pra 2 bie, dhe 2 ka të drejtë të qendrojë tek KAS-i që të flasim dhe jë herë tjetër për këtë çështje. Pika 2 të nenit 28.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: I bie të ndryshosh dhe 27/2, as sipas procedurës se ka parashkuar neni 26. Kryetari propozon miratimin në parim të projektaktit, nqs akti është akt normtiv sipas rastit hap diskutimin nen për nen dhe këtu ndryshon rradha pra: kryetari fton pjesëmarrësit për diskutime dhe më pas anëtarët.

Znj.I.Nano: Nuk është problem 27, problem është 28 dhe atëherë që të kemi pak ekonomi në mbledhje, iku ekonomia sot, prandaj me që kemi dy përfaqësues sot propozimet të jenë më të qarta mundësisht me shkrim absolutisht edhe me gojë është e drejta juaj. Unë në këtë moment nuk kam asnjë propozim për ta hedhur në votim. Na ke vënë të hartojmë propozimin tuaj.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Konceptin ju e keni fut konceptin, për të njëjtën çështje mos fol dy herë. Unë do flas për nenin 18 dhe 37, vendos çdo dy minuta për çdo propozim të parashtruar ose çoje 1 minut dhe të mos e bësh kështu. Nuk kam nevojë për mënyrë përmbledhëse për 8 minuta. Po sikur unë të kem 28 propozime si i bëhet?

Znj.I.Nano: Pikërisht këtë thashë dhe më herët.

Z.Arjan Madhi, përfaqësues i PR: Nuk e bëj propozimin as me shkrim me gojë po se bëtë mos e bëni, unë po zbatoj rregullin ti ma kërkon me shkrim. Unë po zbatoj rregullin po e bëj propozimin me gojë, besoj se kam te drejtë dhe nuk do të më mohohet e drejta per të folur.

Përfaqësues i LSI: Ka të drejtë Arjani dhe në kuadër të asaj që tha Komisioneri pikat të hiqen për të njëjtën çështje dhe nuk kemi pse diskutojmë apo jo ne themi

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

diskutimin tonë dhe nuk ka pse të hyjmë në debat me Komisionin Rregullator në këtë rast.

Znj.I.Nano: Atëherë titulli i nenit propozimi im. Titulli i nenit edhe pas diskutimeve me zonjën Vukaj “Rendi dhe koha në dispozicion për diskutim nen per nen”:

Pika 1, Kryetari administron propozimet për shtesa ndryshime në projektin e propozuar së pari nga subjektet e përcaktuara në nenin 8 pika 1 të kësaj rregullore. Pika 2, më fal mund ta bëjmë diskutime, këta bëjnë propozimet diskutimet i bëjmë ne.

Z.I.Celibashi: Unë mendoj, zgjidheni më thjeshtë, ju përcaktoni rast pas rasti rradhën e diskutimeve dhe kohën e diskutimeve s’ke pse vendos 8 minuta.

Znj.I.Nano: Janë dy momente një është propozimi për një ndryshim nuk është diskutim. Pra, propozimi është i thatë, subjekti zgjedhor thotë “Kam marrë rregulloren dhe unë mendoj që pika 1 e nenit “X” të ndryshojë si më poshtë. Ky është propozimi, diskutimet i bie që i zhvillojmë ne.

Znj.I.Nano: Nen për nen atë po diskutojmë. Jo këtu është vetëm propozim nen për nen. Propozim nen për nen 7 në nenin 27 kur ti vijë radha. Atëherë e riformuljmë së bashku pasi të mbarojmë.

Rendi dhe koha në dispozicion për pjesëmarrësit dhe anëtarët,
së pari do të fillojmë me të drejtën e pjesëmarrësve për të bërë propozimet.
2.me të drejtën e anëtarëve për të bërë propozime dhe diskutime dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

3.me mbyllyen e diskutimeve. Biem dakord në parim dhe e riformulojmë. Për subjektet e parashikuara në nenin 8, në këtë nen parshikohet vetëm e drejta për të bërë propozime me gojë për ndryshime. Me shkrim? Po ti kenë depozituar më herët t'i paraqesin.

Z.D.Çaka: Pa të drejtë replike për t'i dhënë kohë komisionit.

Znj.I.Nano: Vijnë tek neni 29 mbyllja e diskutimeve, pasi kemi ezauruar atë pjesë që thamë mbyllet diskutimi. Mbyllja bëhet nga kryetari me pëlqimin e anëtarëve, të drejtën e mbylljes eka çdo anëtarë. Tek pika 3 kemi diskutim. Pas mbylljes së diskutimeve kryetari fton anëtarët dhe pjesëmarrësit të përfshirë në diskutime të paraqesin diskutimet e tyre. Propozimet janë paraqitur sipas nenit 28, fton anëtarët sepse kanë diskutuar sipas nenit 28 dhe anëtarët. Edhe katra nuk duhet të qëndrojnë para votimit të çdo propozimi. Pra, 3 e heqim, jemi dakord ta heqim

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Neni 30. Votimi i propozimeve të projektakteve që shqyrtohen në mbledhjen e Rregullatorit, Në shqyrtimin e projektaktit Rregullatori voton për përbajtjen e çdo neni apo çdo pjese të tij sipas rastit. Në çdo rast variant i projektaktit do të votohet në tërësi vetëm pasi të jenë votuar propozimet e përfaqësuesve të partive politike, le të themi të subjekteve të përcaktuara në nenin 8 dhe anëtarëve sipa rradhës së propozimit të tyre. Kryetari në përfundim të votimit shpall rezultatin e votimit. Jemi dakord me këtë?

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Kundër: S'ka

Neni 31. Votimi në Komisionin Rregullator është i hapur. Votimi i hapur bëhet me ngritjen e dorës ose me deklaram. Anëtari i Rregullatorit voton "pro" ose "kundër", Abstenimi nuk lejohet. Me kërkesën e tij, anëtari ka të drejtë të shpjegojë votën "kundër". Vendimet merren kur pro tyre votojnë së paku katër anëtarë, përveç vendimeve sipas shkronjave "b" dhe "d" të pikës 2 të nenit 20 të Kodit Zgjedhor, të cilat miratohen me shumicë të thjeshtë. Jemi dakord me këtë keni ndonjë gjë?

Z.M.Çakaj: I vetmi merak që kisha unë, po që është sqaruar më poshtë tek neni 23 pika 2 është dhe mendimi paralel, por që e kemi sqaruar më poshtë, pra nëse unë votoj njësoj si ju, por kam një arsyetim tjetër.

Znj.I.Nano: Dakord! Me 31 a jemi dakord?

Kush është dakord?


Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Të kalojmë te 32. "Regjistrimi i mbledhjeve është një proces që është zhvilluar edhe më herët, regjistrohet me zë, ose dhe me figurë, për çdo mbledhje mbahet proces verbal, që mban datën, vendin, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan në kuptimin e çështjeve në rendin e ditës, një përmbledhje diskutimesh, vendimet e marra si dhe mënyra si është votuar dhe rezultati i votimit. Jemi dakord?

Z.I.Celibashi: Vetëm diçka këtu për saktësim. Të gjitha mbledhjet e Rregullatorit regjistrohen saktësisht me zë dhe kur është rasti edhe me figurë, nuk e kemi për

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

çdo rast, të paktën për momentin...Me zë duhet të jetë domosdoshmërisht se kështu duket sikur ose edhe me figurë.

Znj.I.Nano: Jo jo, kur thua ose me zë ose.., e lexojmë edhe njëherë: Elektronikisht me zë, ose edhe me figurë, pra e le alternativë edhe me zë, kështu që kjo duhet të jetë “regjistrohet me zë, kur është rasti ose e mundur edhe me figurë”.

Ruajtja në arkivë e regjistrimeve sipas akteve ligjore, nënligjore në fuqi, nëse për shkak të intensitetit, para nënshkrimit të aktit të miratuar, nuk do kemi mundësi të marrim procesverbalin, atëhere do kemi regjistrimin audio.


Znj.H.Vukaj: Gjithësesi, duhet pasur parasysh, në përputhje me nenin 98, forma e aktit administrativ, të Kodit të Procedurave Administrative, pika 5 thuhet: “Aktet e organeve kolegjiale, bëhen në formë shkresore. Këto akte regjistrohen në një procesverbal, pa të cilin ato nuk sjellin asnjë pasojë juridike” kështu që, mbetet që procesverbali duhet domosdoshmërisht para nënshkrimit.

5 e 98 “forma e aktit administrativ” ku thuhet “Këto akte regjistrohen në një procesverbal, pa të cilin ato nuk sjellin asnjë pasojë juridike”, është taksative.

Znj.I.Nano: Te forma e aktit, unë e di që zoti Çakaj ka një propozim, është diskutuar dhe më herët pra, forma e aktit ka, stemën e Republikës, emrin e institucionit, KQZ-ja, emrin e organit që nxjerr aktin (Komisioni Rregullator), titulli i aktit, baza ligjore, pjesa arsyetuese,(sipas rastit) pjesa urdhëruese, (sipas rastit) dhe ketu kemi të drejtën e ankimit sipas rastit.

Z.M.Çakaj: Në të gjitha rastet ka të drejtën e ankimit, vetëm të drejtën e ankimit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.H.Vukaj: Edhe të drejtën e ankimit.

Znj.I.Nano: Në këtë rregullore do ta vendosim të drejtën e ankimit?

Z.M.Çakaj: Po, ta vendosim.

Znj.I.Nano: E lëmë sipas rastit dhe e shohim sipas rastit, sepse të gjitha....

Z.M.Çakaj: Arjani ka interes të ligjshëm të ankohet për...

Znj.I.Nano: Mund t'i drejtohet ligjit direkt, e drejta e ankimit, buron nga ligji, në fakt nuk buron nga akti.

Znj.H.Vukaj: Jo jo e bën aktin e pavlefshëm, osë të paligjshëm, në varësi të llojit aktit.

Znj.I.Nano: po pra ndaj them sipas rastit..

Znj.H.Vukaj: Të paligjshëm, të pavlefshëm, duhet patjetër për anë formale, nuk diskutohet e drejta e ankimit.

Znj.I.Nano: Si do ta formulonim të drejtën e ankimit për këtë rregullore?

Z.M.Çakaj: Të gjitha palët e interesuara, kanë të drejtë të bëjnë ankim, përveç rregullores.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Znj.I.Nano: Pra për rregulloren, s'kanë të drejtë të bëjnë ankim?

Znj.H.Vukaj: S'kanë të drejtë të bëjnë ankim për rregulloren se është akt normativ ligjor i karakterit kolektiv..

Znj.I.Nano: Prandaj them të drejtën e ankimit...

Znj.H.Vukaj: Nuk ia heq dot të drejtën. Bëje përgjithësisht. Le të ankohen për rregulloren!

Znj.I.Nano: Nëse themi sipas rastit, atëhere do ta lidhim me tipologjinë a aktit që miratojmë, të drejtën e ankimit. Nëse the të drejtën e ankimit, duhet dhe te kjo rregullore të vendosësh. Ma formulo dispozitën për të drejtën e ankimit këtu.

Z.M.Çakaj: Kundër këtij akti, palët e interesuara mund të bëjnë ankim.

Znj.I.Nano: Ku e ke në cilin nen e bazon? Në cilin nen të Kodit Zgjedhor. Ja e kam Kodin Zgjedhor këtu. Cili nen se e hap unë. Pra që kur thua pjesën arsyetuese sipas rastit se në fakt ankimi lidhet me ... e Muharrem.

Z.M.Çakaj: A është ky akt administrativ me karakter normativ? Po. Pra është akt administrativ me karakter normativ, kështu që ky akt për nga përmbajtja e tij për nga natyra e tij ankimohet në Kolegjin Zgjedhor, kështu që çfarëdo lloj akti që miratojmë ne është i ankimueshëm në Kolegjin Zgjedhor. Është e padiskutueshme. Jo unë jo besoj.. atëherë të gjitha aktet që miraton Rregullatori, pra gjithë aktet që miraton KQZ-ja, në rastin konkret Rregullatori dhe më pas KAS-i duhet të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

përfshijnë të drejtën e ankimit, jo vetëm subjektet zgjedhore po edhe ..të drejtën e ankimit thatë pse ku është....

Pa mikrofon

Muharrem Cakaj: Në fund fare të drejtën e ankimit palët që kanë interes të ligjshëm janë përfaqësuesit sipas pikës .. Si...

Znj.I.Nano: Biem dakord sipas rastit.

Pa mikrofon

Znj.H.Vukaj: Dhe unë i besoj eksperiencës suaj institucionale në këtë institucion edhe...

Pa mikrofon

Z.I.Celibashi: Nëse është, as nuk e nxit as nuk e pengon nëse është e shkruar.

Znj.H.Vukaj: Ashtu duket sikur ia ke hequr dhe pastaj e godet për formë. Pse duhet të godasi për formë kur ti ke në dorë ta vendosësh atë...

Znj.I.Nano: E lexojmë dhe njëherë stemën e Republikës ...

Znj.H.Vukaj: Nuk e kuptoj këtë këmbënguljen tuaj për mos ta vënë ndërkohë që

Znj.I.Nano: Jo jo unë i mora me rradhë Helga. Tani për të gjetur ku jemi dakord dhe ku jo..

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.I.Celibashi: Mund të bëj dhe një ndërhyrje tjetër dhe do e mbyll pastaj. Nëse i referohemi Kodit Zgjedhor neni 144 “pika 1, vendimi i KQZ-së është gjithmonë i formës së shkruar, pika 2, vendimet e KQZ-së për ankimet zgjedhore përmbajnë:, pika 3, vendimi i KQZ-së përmban numrin, datën etj etj...pika 4, dhe 5 thonë vendimi i KQZ-së përmban edhe sqarim për të drejtën e palëve për të ankimuar në rrugë gjyqësore dhe afatet e ankimit. Kështu, unë mendoj që duhet ta shënoni. Duhet ta shënoni të drejtën e ankimit mendoj unë. Te vendimi që do ta miratoni ju se me vendim do ta miratoni rregulloren një pikë shtohet që..

Znj.I.Nano: Atëherë dhe një herë e nisim. Stemën që përmban emrin e institucionit të KQZ, përmban emrin e organit që nxjerr aktin si njësi rregullatore, përmban titullin e aktit po, bazën ligjore po pjesën arsyetuese sipas rastit?

Z.M.Çakaj: Si pjesën arsyetuese, se ka akte si puna e këtij apo akte të tjera që pjesa arsyetuese ezaurohet ne relacion.

Znj.I.Nano: Pjesën urdhëruese sipas rastit apo në çdo rast? Pjesën arsyetuese germa g sipas rastit apo në çdo rast?

Z.M.Çakaj: Pjesën urdhëruese në çdo rast, sepse është karakteri normativ i aktit.

Znj.I.Nano: “g” “gj” çfarë vendosim? Në të drejtën e ankimit, nuk do themi sipas rastit, emrat e antarëve që kanë marrë pjesë në votim

Logon e KQZ-së

Numrin, datën dhe orën e miratimit

Mënyrën e votimit se cili anëtar është pro apo kundër.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Po dakord.

Znj.I.Nano: Akti nënshkruhet nga antarët që kanë votuar. Çdo akt mund të shoqërohet si pas rastit me mendim pakice apo mendim paralel.

Z.M.Çakaj: Po dakord.

Znj.I.Nano: Dakord me formulimin e nenit 33? Të gjithë dakord?

Kush është dakord?

Pro: 5(*znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela*)

Kundër: S'ka

Nënshkrimi i aktit. Akti hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga Kryetari dhe antarët e Rregullatorit. Nënshkrimet vendosen edhe në lidhje bashkëngjitur aktit të miratuar. Anëtarët e nënshkruajnë dhe në rastin nëse nuk janë dakord me pjesën arsyetuese mund të paraqesin një mendim paralel. Zbardhja e akteve bëhet jo më vonë se 24 orë gjatë periudhës zgjedhore dhe jo më vonë se 5 ditë pune gjatë periudhës jozgjedhore. Gjithmonë kemi parasysh me periudhë zgjedhore dhe jo zgjedhore ndarjen nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar.

Dakord me nenin 34?

Kush është dakord?

Pro: 5(*znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela*)

Kundër: S'ka

Neni 35. Regjistrimi i akteve dhe dokumentacionit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Regjistrimi i akteve bëhet në dy regjistra. Regjistri i koorespondencës dhe regjistri i vendimeve. Pra duhet të çelet një regjistër i vendimeve të Rregullatorit. Administrimi i regjistrave bëhet nga zyra e protokollit pranë administratës. Kjo rregullore hyn në fuqi.

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S'ka

Ilirjan Celibashi: Edhë këtu ta evitojme se është parazite bëhet nga zyra e protokollit.

E para se nuk ka një zyrë dmth ... bëhet pranë administratës së KQZ-së.

Znj.I.Nano: Pranë protokollit të KQZ-së dhe nënkuptojmë specialist, zyrë, njësi....

Z.I.Celibashi: Pranë administratës së KQZ-së, se mund të jetë një strukturë që ... administratës së KQZ-së pastaj se kush është...


Pranë administratës së KQZ-së.

Znj.I.Nano: Dakord, kemi disa të tjera me administratën.

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Faqen Zyrtare të KQZ. Në botimet zyrtare e konsultuam që nuk është te aktet që ligji i botimeve zyrtare ..

Atëherë ligjin për botimet zyrtare unë e pashë dhe aktet e KQZ-së nuk janë ndër aktet e botueshme të cilat përmenden në mënyrë nominale në këtë ligj. Përfundimi është edhe akte të tjera që janë të detyrueshme për tu botuar por sipas ligjit, dhe ligji që i referohemi është Kodi Zgjedhor. Unë në Kodin Zgjedhor prap nuk kam parë.. (ndërhyrje pa mikrofon) Jo për Fletoren Zyrtare, flasim për Fletoren Zyrtare, çfarë praktike keni pasur?

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Z.M.Çakaj: Praktikrat e mëparshme si kanë qenë?

Znj.I.Nano: Nuk janë botuar në fletoren zyrtare?

Z.I.Celibashi: Në kohën time publikoheshin në Fletore Zyrtare.

Z.D.Çaka: Rregullorja miratohet me vendim dhe vendimi duhet të jetë pjesë se s'bën e Fletores Zyrtare.

Znj.I.Nano: Jo flasim për botim në Fletoren Zyrtare. Pikërisht këtë jam duke thënë. Për mua s'ishte në grupin...Do e hapi njeri ligjin për botimet zyrtare?

Diskutime pa mikrofon

Znj.I.Nano: Atëherë në Fletoren Zyrtare sipas këtij ligji, ligjit të Botimeve Zyrtare, "Botohen ligjet, dekretet e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, aktet normative të Këshillit të Ministrave, aktet normative të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve qendrore, nuk është rasti ynë, vendimet, rezolutat, deklaratat e Kuvendit të Shqipërisë, vendimet e GJEDNJ, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e ..kemi te kodi jonë? Vendimet e Kolegjeve të Bashkuara, të gjitha akte të tjera botimi i të cilave është i detyrueshëm nga legjislacioni në fuqi.

Zj.H.Vukaj: Mirë kjo është kuadër që rregullon marrëdhëniet brenda institucionit për t'i klasifikuar llojet e akteve. Por s'heq mundësinë referuar nenit 136. Botimi i akteve në Fletore Zyrtare. Botimi i akteve administrative në Fletoren Zyrtare është i detyrueshëm kur një gjë e tillë është i kërkuar nga ligji. Mosbotimi i aktit në

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.26.10.2020*

Fletoren Zyrtare kur kjo kërkohet shprehimisht nga ligji, shkakton moshyrjen në fuqi të aktit..

Znj.I.Nano: Po pra nuk e kërkon detyrimisht asnjë ligj, as Kodi Zgjedhor pra Ligji i Botimeve Zyrtare nominalisht duhen botuar të tjerat sipas parashikimeve ligjore. Votojmë në tërësi projektaktin “Për miratimin e rregullores së mbledhjeve të Komisionit Rregullator”

Kush është dakord?

Pro: 5(znj.Nano, znj.Vukaj, z.Çaka, z.Çakaj, z.Çela)

Kundër: S’ka

Miratohet

I urojmë edhe një herë punë të mbarë Komisionit Rregullator me miratimin e vendimit të tij të parë. I lutemi administratës të zbardhë ndryshimet e propozuara për çdo nen para nënshkrimit të vendimit.

Faleminderit, mbyllim mbledhjen

Vendimi Nr. 1

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

